



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “ Inxhinieri
Gjeoinformatikë”**

ofruar nga

“ Universiteti Politeknik i Tiranës”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Dr. Julinda Keçi

Dr. Alketa Grepcka

Shkurt/2025

Tabela Përmbledhëse për Programin e studimit Bachelor në "Inxhinieri Gjeoinformatikë" ofruar nga "Universiteti Politeknik i Tiranës"

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti Politeknik i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Gjeologjisë së Zbatuar dhe Gjeoinformatikës
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në "Inxhinieri Gjeoinformatikë"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Shkresë MASH Nr.1583/1 Prot, datë 12.05.2006.
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 151, datë 16.04.2021.
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-.
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli gjashtë (6)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2021-2022: 39 PAE/1 PAK 2022-2023: 39 PAE/2 PAK 2023-2024: 36 PAE/2 PAK
18	Numri i studentëve:	2021-2022: 50 studentë 2022-2023: 37 studentë 2023-2024: 22 studentë
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në "Inxhinieri Gjeoinformatikë" është miratuar përmes procedurave ligjore përkatëse nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës përmes Shkresës MASH Nr.1583/1 Prot, datë 12.05.2006. Ky program përfaqëson një fushë të re dhe të rëndësishme të inxhinierisë që ndërthur teknologjinë e informacionit me shkencat gjeologjike, duke iu përgjigjur nevojave të tregut modern të punës. Ky program studimi nuk ka kaluar më parë në proces akreditimi.

Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar dhe vlerësimin e brendshëm të cilësisë, si dhe nga vizitat institucionale, programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri Gjeoinformatikë" është një program i ciklit të parë me kohë të plotë, zhvillohet në gjuhën shqipe dhe përfshihet në nivelin e 6- të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Programi ka një kohëzgjatje normale prej 3 vitesh akademike dhe mbulon gjithsej 180 ECTS.

Objektivi kryesor i programit është të përgatisë profesionistë të aftë për të kombinuar teknologjinë e informacionit dhe analizat gjeohapësinore me inxhinierinë, duke zhvilluar aftësi në përdorimin e sistemeve të informacionit gjeografik, hartografimin dixhital dhe teknologjitë përpunuese të të dhënave gjeoinformatike. Në përfundim të studimeve, studentët do të jenë të aftë të kontribuojnë në projekte të fushës së gjeoinformatikës, duke përfshirë kërkimin dhe zbatimin e teknologjive gjeohapësinore në sektorë si urbanistika, infrastruktura, mjedisi dhe menaxhimi i burimeve natyrore.

Programi ofron njohuri të mjaftueshme për t'u integruar në tregun vendas të punës, si dhe në projekte ndërkombëtare që kërkojnë ekspertizë në përdorimin e teknologjive gjeoinformatike. Gjithashtu, studentët që përfundojnë këtë program kanë mundësinë të vazhdojnë studimet në ciklin e dytë Master, për të thelluar njohuritë dhe aftësitë e tyre në fushën e gjeoinformatikës dhe shkencave inxhinierike.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) është ngritur nga ASCAL mbështetur në kërkesën e Universitetit Politeknik të Tiranës, regjistruar në protokollin e ASCAL. GVJ përbëhet nga dy anëtarë Dr. Julinda Keçi dhe Dr. Alketa Grepcka. dhe koordinatori teknik për ASCAL në këtë procedurë vlerësimi është Msc. Alma Arapi.

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm janë përzgjedhur duke patur në konsideratë kompetencat profesionale në lidhje me fushën e këtij programi studimi, eksperiencën e tyre në vlerësime të programeve të studimit, integriteti profesional, mungesa e konfliktit të interesit për të siguruar paanshmërinë dhe objektivitetin në gjykim dhe në vlerësim.

GVJ, në punën e tij, ka shfrytëzuar "Raportin e vlerësimit të brendshëm" të hartuar nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB), i ngritur pranë Departamentit të Gjeologjisë së Zbatuar dhe Gjeoinformatikës, Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave, si dhe dokumentacionin në Dosjen e Vetëvlerësimit (DVV) e përbërë nga 134 dokumenta.

Në kuadër të hartimit të raportit, grupi ka vepruar me ndarje pune, detyrash dhe përgjegjësisish të përcaktuara qartë për secilin anëtar. Të dhënat e vëna në dispozicion përmes DVV u diskutuan dhe u verifikuan gjatë takimeve vlerësuese të zhvilluara më 04.07.2021 dhe 05.07.2024, në kujdesin e koordinatores teknike të ASCAL, Msc. Alma Arapi. Institucioni kishte marrë të gjitha masat për realizimin me sukses të takimeve, në përputhje me agjendën e vizitës.

Raporti i përgatitur përmbledh rezultatet e shqyrtimit të dokumentacionit të DVV, si dhe të konkluzioneve të mbledhura dhe të diskutuar gjatë takimeve me përfaqësuesit e Institucionit.



Subjekti: Relacion për përgjigjet e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm për raportin e hartuar nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Gjeoinformatikë”

Bazuar në shkresën 284/3 “ Relacion me përgjigjet mbi komentet rreth Draft- Raportit të Vlerësimit të Jashtëm dhe ASCAL për procesin e akreditimit për programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Gjeoinformatikë” , GVJ konkludon si vijon më poshtë:

Nr.	Standarti/kriteri	Komenti I paraqitur nga institucioni pranohet/nuk pranohet
1	Standarti I.1, kriteri 3	Pranohet
2	Standarti I.2, kriteri 3	Pranohet
3	Standarti II.1, kriteri 5	Pranohet
4	Standarti II.4, kriteri 1	Pranohet
5	Standarti II.4 konkluzione	Pranohet
6	Standarti III.2, kriteri 3	Pranohet
7	Standarti III.4, kriteri 5	Pranohet
8	Standarti IV.3, kriteri 5	Pranohet
9	Standarti IV.3, kriteri 6	Pranohet
10	Standarti IV.4, kriteri 3	Pranohet
11	Standarti VI.3, kriteri 3	Pranohet

Bazuar edhe në relacionin e paraqitur nga institucioni konstatojmë një reflektim të Institucionit në lidhje me rekomandimet e dhëna dhe biem dakord me komentet e paraqitura.

Grupi i punës:

Dr. Alketa Grepcka

Dr. Julinda Keçi

Universiteti Politeknik i Tiranës , është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 24.01.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 30/ 2 Prot, datë 24.01.2025. Universiteti Politeknik i Tiranës njofton në ASCAL më datë 10.02.2025, me anë të shkresës me Nr.284/3 Prot, datë 06.02.2025 “ Kthim përgjigje për Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit”, ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtar si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Inxhinieri Gjeoinformatikë”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti Politeknik i Tiranës është institucion i Arsimit të Lartë me status të personit juridik dhe në qendër të veprimtarisë së tij ka lirinë akademike si nocion universal [Ref_001 Statuti i UPT]. Programet e ofruara nga ky institucion nuk bien ndesh me interesat kombëtare, madje në kundërshtim kontribuon në rritjen e vlerave të vetë institucionit dhe të vendit në tërësi përmes ofrimit të programeve në tre cikle të studimit të cilat garantojnë cilësi në mësimdhënie dhe ofrojnë përmes studentëve të diplomuar cilësi në tregun e punës [Ref_011 Plani Mesimor PS BSc në Inxhinieri Gjeoinformatike]. UPT ofron programe studimi pjesë e të cilës është edhe programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Gjeoinformatikë” të cilat forcojnë vlerat akademike dhe kulturore. Në pikën 6 të nenit 3 në Statutin e UPT theksohet: <i>“UPT mbështet dhe mbron studentët në ushtrimin e të drejtës së tyre për arsim cilësor dhe siguron përfaqësimin e tyre si partnerë të plotë në qeverisjen e tij. UPT përpiqet në promovimin e mirëkuptimit ndërkulturor, mendimit kritik, tolerancës politike dhe fetare, barazisë gjinore, vlerave demokratike dhe qytetare, në mënyrë që të forcojnë qytetarinë Evropiane dhe globale të studentëve, të cilët do të hedhin themelet për një shoqëri gjithëpërfshirëse”</i> .
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	UPT zhvillon veprimtarinë e tij në përputhje me qëllimin, vizionin dhe misionin e tij të cilat shprehen qartë në nenin 3 në Statut të UPT-së. Qëllimi kryesor është përparimi i shkencës, i teknologjisë dhe i arsimit të lartë nëpërmjet integritit të tyre. UPT promovon dhe rrit rolin e tij në procesin e zhvillimit të shoqërisë, përmes transferimit të teknologjisë dhe informacionit, si edhe shërbimeve për territorin dhe komunitetin. Misioni i tij është: • të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë e të mbrojë dijet me anën e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve, si edhe të formojë specialistë të lartë dhe të përgatitë shkencëtarë të rinj; • të ofrojë mundësi për të përfutur nga arsimi i lartë gjatë gjithë jetës në fushat e tij të ekspertizës; • të ndihmojë zhvillimin ekonomik në nivel kombëtar dhe rajonal;

	të kontribuojë në rritjen e standardeve të demokracisë e të qytetërimit të shoqërisë dhe në përgatitjen e të rinjve për një shoqëri të tillë. Veprimtaria akademike e UPT zhvillohet në përputhje me parimet dhe standardet e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë (HEAL), duke reflektuar parimet dhe objektivat e Procesit të Bolonjës [Ref_001 Statuti i UPT; Ref_002 Plani Strategjik i UPT; Ref_007 Plani strategjik FGJM; Ref_009 Plani Strategjik DGJZGJ]. Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Inxhinieri Gjeoinformatikë” është hartuar në përputhje me misionin e institucionit dhe në përputhje me fushën e veprimtarisë së tij [Ref_011 Plani Mesimor PS BSc në Inxhinieri Gjeoinformatike].
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.	Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Gjeoinformatikë” zhvillohet në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të Institucionit [Ref_002 Plani Strategjik i UPT]. Synimet kryesore të Strategjisë së zhvillimit të UPT 2019-2024 janë pjesë përbërëse e synimeve të këtij program studimi. GVJ konstaton pika kryesore si: 1. Ndërkombëtarizimi përmes rritjes së njohjes ndërkombëtare të diplomës së ofruar në këtë program studimi; 2. Rritja e veprimtarisë ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor përmes pjesëmarrjes në projekte kërkimore kombëtare, evropiane dhe rajonale; 3. Zgjerimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e shkëmbimit të personelit akademik; 4. Intesifikimi i shkëmbimeve të studentëve në përputhje me kornizën e marrëveshjeve dypalëshe; 5. Zhvillimi i një infrastrukture të qëndrueshme me synimin në përgatitjen e studentëve me aftësi në fushën e inxhinierisë minerare; Plani Strategjik i Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave (2018-2023) synon ndërkombëtarizimin e FMGJ në kuadër të UPT-së, menaxhimin institucional të tij përmes zhvillimit të qëndrueshëm të kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukture [Ref_007 Plani strategjik FGJM]. GVJ konstaton se edhe Departamenti i Gjeologjisë së Zbatuar, Mjedisit dhe Gjeoinformatikës ku zhvillohet edhe programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Gjeoinformatikë” zhvillon një strategji zhvillimi dhe kërkimi (2018-2023) në përputhshmëri me planin strategjik të FMGJ dhe UPT-së.[Ref_009 Plani Strategjik DGJZGJ]. GVJ konstaton se strategjitë tashmë janë në limite kohore të tyre dhe propozon një rishikim të tyre [Ref_002 Plani Strategjik i UPT; Ref_007 Plani strategjik FGJM; Ref_009 Plani Strategjik DGJZGJ].
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka	UPT zotëron kapacitete dhe burime të duhura për të mundur zhvillimin e programit mësimor Bachelor në “Inxhinieri

përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.

Gjeonformatikë”. Ky program zhvillohet në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave (FGJM) i cili përbëhet nga katër njësi bazë si vijon më poshtë:

1. Departamenti i Shkencave të Tokës;
2. Departamenti i Inxhinierisë së Burimeve Minerare;
3. Departamenti i Inxhinierisë së Burimeve të Energjisë;
4. Departamenti Gjeologjia e Zbatuar dhe Gjeoinformatika (ku zhvillohet edhe programi i studimit në ciklin e parë Bachelor “Inxhinieri Gjeoinformatikë”).

Të dhënat statistikore shprehin një qëndrueshmëri të stafit akademik në nivel Fakulteti dhe në nivel departamenti. Tabela më poshtë jep një pasqyrë të numrit total të stafit akademik në vitet e FMGJ-së.

UPT	Fakulteti I Gjeologjisë dhe Minierave			
	Numri PAE	Numri PAK	Numri P ndihmes akademik	Total
	Gj	Gj	Gj	
2023-2024	49	33	13	95
2022-2023	55	28	13	96
2021-2022	53	37	13	103

Departamenti i Gjeologjisë së Zbatuar dhe Gjeoinformatikës

Staf Akademik	PAE	PAK	Nr P.ndihmës akademik	Total
2023-2024	12	12	3	27
2022-2023	13	11	3	27
2021-2022	12	11	3	26

UPT	Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave (2023-2024)					Total
	Numri PAE		Numri PAK		Numri P ndihmes akademik	
	Gj	Tituj, Grada	Gj	Tituj, Grada	Gj	
Departamenti I Shkencave të Tokes	12	(7) Prof. Dr. (2) Prof. Asoc. (2) Dr. (1) Dr. proc. (0) Msc	9	(3) Prof. Dr. (1) Prof. Asoc. Dr. (3) Dr. (0) Dr. proces (2) Msc.	4	25
Departamenti I Inxhinierisë së burimeve minerare	11	(3) Prof. Dr. (2) Prof. Asoc. (5) Dr. (0) Dr. proc. (1) Msc	8	(0) Prof. Dr. (2) prof. Asoc. Dr. (3) Dr. (0) Dr. proces (3) Msc.	3	22
Departamenti I Inxhinierisë së burimeve të energjisë	12	(2) Prof. Dr. (0) Prof. Asoc. (4) Dr. (0) Dr. proc. (6) Msc	12	(2) Prof. Dr. (0) prof. Asoc. Dr. (0) Dr. (0) Dr. proces (10) Msc.	3	27
Departamenti Gjeologjia e Zbatuar dhe Gjeoinformatika	14	(0) Prof. Dr. (4) Prof. Asoc. (10) Dr. (0) Dr. proc. (0) Msc	4	(0) Prof. Dr. (1) prof. Asoc. Dr. (0) Dr. (0) Dr. proces (3) Msc.	3	21

TOTAL	49	(12) Prof. Dr.	33	(5) Prof. Dr.	13 (P. ndihmes akademik)	95
		(8) Prof. Asoc.		(4) prof. Asoc. Dr.		
		(21) Dr.		(6) Dr.		
		(1) Dr. proc.		(0) Dr. proces		
		(7) Msc		(18) Msc.		

Në mbështetje të programit të studimit angazhohet edhe një personel ndihmës akademik (3 në departamenti dhe 4 në nivel fakulteti). Institucioni ofron një infrastrukturë të duhur për zhvillimin e programit mësimor me një bazë të gjerë laboratorike [Ref_064 Relacion mbi Infrastrukturen në FGJM; vizitë në institucion].

Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për

Programi i studimit ofrohet në Fakultetin e Gjeologjisë së Minierave (FGJM) në Departamentin e Gjeologjisë së Zbatuar dhe Gjeoinformatikës (DGJZGJI). Fusha e studimit në Fakultetin e Gjeologjisë së Minierave është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë bazë dhe të programit të studimit. Bazuar edhe në evidencat e paraqitura Fakulteti i Gjeologjisë së Minierave ofron një larmi programesh që variojnë nga niveli Bachelor deri në studime Doktorature në fushën e shkencave të tokës, burimeve minerare, burimeve të energjisë dhe gjeologjisë së zbatuar dhe

programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	gjeoinformatikës. Në total kjo njësi kryesore ofron 5 programe studimi në ciklin e parë, 2 në ciklin e dytë (MSc), 5 në MP dhe 1 në programin e doktoraturës. Tabela më poshtë jep një pasqyrë të programeve të studimit sipas departamenteve dhe ofrimin në total të 13 programe studimi. <table><tr><th rowspan="2">UPT</th><th colspan="5">Viti akademik 2023-2024</th><th rowspan="2">Total</th></tr><tr><th>Nr. i Programeve BSc.</th><th>Numri i programeve MSc.</th><th>Numri i programeve MP</th><th>Numri i programeve Master I Integruar</th><th>Numri i programeve Dr.</th></tr><tr><td>Departamenti I Shkencave të Tokës</td><td>2</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>1</td><td>3</td></tr><tr><td>Departamenti I Inxhinierise se burimeve minerare</td><td>1</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td><td>-</td><td>2</td></tr><tr><td>Departamenti I Inxhinierise se burimeve te energjise</td><td>1</td><td>1</td><td>1</td><td>-</td><td>-</td><td>3</td></tr><tr><td>Departamenti Gjeologjia e Zbatuar dhe Gjeoinformatika</td><td>1</td><td>1</td><td>3</td><td>-</td><td>-</td><td>5</td></tr><tr><td>Total</td><td>5</td><td>2</td><td>5</td><td>-</td><td>1</td><td>13</td></tr></table>						UPT	Viti akademik 2023-2024					Total	Nr. i Programeve BSc.	Numri i programeve MSc.	Numri i programeve MP	Numri i programeve Master I Integruar	Numri i programeve Dr.	Departamenti I Shkencave të Tokës	2	-	-	-	1	3	Departamenti I Inxhinierise se burimeve minerare	1	-	1	-	-	2	Departamenti I Inxhinierise se burimeve te energjise	1	1	1	-	-	3	Departamenti Gjeologjia e Zbatuar dhe Gjeoinformatika	1	1	3	-	-	5	Total	5	2	5	-	1	13
UPT	Viti akademik 2023-2024					Total																																															
	Nr. i Programeve BSc.	Numri i programeve MSc.	Numri i programeve MP	Numri i programeve Master I Integruar	Numri i programeve Dr.																																																
Departamenti I Shkencave të Tokës	2	-	-	-	1	3																																															
Departamenti I Inxhinierise se burimeve minerare	1	-	1	-	-	2																																															
Departamenti I Inxhinierise se burimeve te energjise	1	1	1	-	-	3																																															
Departamenti Gjeologjia e Zbatuar dhe Gjeoinformatika	1	1	3	-	-	5																																															
Total	5	2	5	-	1	13																																															
Konkluzione	GVJ konstaton se Universiteti Politeknik i Tiranës tashmë është një institucion qe përmbush të gjithë kriteret për të ofruar programe studimi në të tre ciklet. Programi i studimit “Inxhinieri GjeoInformatikë” ofrohet në Fakultetin e Gjeologjisë së Minierave në Departamentin e Gjeologjisë së Zbatuar dhe Gjeoinformatikës. Njësia kryesore dhe njësia bazë zhvillojnë procesin në përputhshmëri me misionin, dhe strategjinë e zhvillimit të UPT-së. Evidencat e paraqitur tregojnë për një qëndrueshmëri te stafit akademik dhe për një infrastrukturë të duhur për të garantuar porcesin mësimor në programin e studimit Bachelor në “Inhinieri GjeoInformatikë”.																																																				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	X																																																

Standardi I.2 Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e	UPT ushtron aktivitetin e tij bazuar në dokumenta ligjore institucionale të hartuara në përputhje me kërkesat ligjore të ligjit nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. /Ref_001 Statuti i UPT; Ref_003 Kodi i Etikës në UPT; Ref_004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënie UPT/. Kreu II në Statut përcakton strukturën akademike të UPT-së të cilën GVJ e gjen në përputhje edhe me organigramën e institucionit. /Ref_001 Statuti i UPT; Ref_005 Organigrama e UPT/. Detyrat dhe përgjegjësitë janë dhënë qartë në kapitullin “Autoritete Drejtuese të

personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	UPT-së”, ku neni 19 dhe 20 përcakton detyrat e autoritetit të njësisë kryesore dhe njësisë bazë. Referuar edhe rregullores së Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies këto detyra përcaktohen qartë hartimi dhe zhvillimi i programeve të studimit ku Kreu I – IX përshkruajnë qartë edhe dispozitat ligjore të funksionimit të programeve të studimit të ofruara në këtë institucion. /Ref_004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies UPT/. Më eksplicite GVJ gjen një ndarje të detyrave dhe përgjegjësiwe në Rregulloren e Njësisë Bazë dhe ne Rregulloren e Programit të Studimit. /Ref_006 Rregullore e brendshme FGJM_2020 ; Ref.92. Ref_008 Rregullore e brendshme e DGJZGJ; Ref_010 Rregullore PS BSc në Inxhinieri Gjeoinformatike/. Specifikat në lidhje me lëndët, ngarkesën mësimore dhe detyrimet e studentëve janë dhëne qartë në Rregulloren e Programit të Studimit. /Ref_010 Rregullore PS BSc në Inxhinieri Gjeoinformatike/. Në këtë kontekst GVJ gjen një kuadër ligjor që buron nga niveli i vendimarrjes deri në nivelin e programit të studimit të institucionalizuar ku secila hallkë ka të përcaktuar qartë rolin e saj. Për sigurimin e veprimtarisë mësimore Departamenti i Gjeologjisë së Zbatuar dhe Gjeoinformatikës si hallkë e Fakultetit të Gjeologjisë së Minierave bashkërendon punën e tij me tre departamentet e tjera pjesë përbërëse e strukturës së FMGJ-së. Për këtë program studimi angazhohet edhe staf akademik nga njësi të tjera kryesore të UPT ku përmendim: Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit. Bazuar në të dhënat GVJ konstaton mbulimin e 11 lëndëve në këtë program studimi nga 35 pedagogë jashtë strukturës së FMGJ-së të cilët janë pjesë e 11 departamenteve në UPT. Në këtë kuadër konstatojmë bashkëpunimin edhe me struktura organizitive ku përmendet Drejtoria e Bibliotekës Shkencore, Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit, Drejtoria e Kerkimit Shkencor dhe Projekteve, Drejtoria e Kurrikulave, Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Juridike ku marrëdhëniet janë përcaktuar qartë në rregulloret përkatëse të këtyre strukturave. /Ref_005 Organigrama e UPT/.
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me	Për realizimin e programit të studimit nga ana e Departamentit të Gjeologjisë së Zbatuar dhe Gjeoinformatikës konsiderohet e rëndësishme bashkëpunimi me të gjithë hallkat brenda dhe jashtë institucionit të cilat japin një impakt pozitiv në program dhe veçanërisht tek studentët që diplomohen në këtë program studimi. Në këtë drejtim FGJM ka nënshkruar një sërë marrëveshje bashkëpunimi me palë të ndryshme me qëllim bashkëpunimin ndër-

institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	institucional dhe shkëmbim përvojë profesionale. Ndërtimi i partneriteteve me shoqërinë civile, dhe komunitetin e biznesit konsiderohet si një nga përfitimet kryesore në fushën e mësimdhënies, kërkimit shkencor. Nga zhvillimi i këtyre veprimtarive bashkëpunuese FGJM synon në përfitimin: • Lëvizshmëria e stafit/studentëve dhe vënia në dispozicion e kapaciteteve të ndërsjellta; • Shkëmbime përvojash, eksperiencia konkrete dhe përgatitja e studentëve të këtij program studimi si kapacitete potenciale për punësime të ardhshme në këto institucione bashkëpunuese; • Aplikime për programe specifike kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor të cilat do t'ju shërbejnë palëve bashkëpunuese në funksion të përfitimeve të ndërsjellta të tyre; • Organizime të përbashketa me karakter shkencor, trajnime, aktivitete studentore si botime, konferenca etj. Në këte kuadër GVJ shqyrtoi me vëmendje evidencat e paraqitura nga intitucioni për bashkepunimet dhe impakti i tyre në programin e studimit. Më konkretisht bazuar edhe në takimin me Përfaqesuesin e Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit dhe Drejtorisë së Kërkimit Shkencor dhe Projekteve konstatojmë: a. 13 marrëveshje bashkëpunimi me IAL-të në vend; b. 34 marrevëshje bashkëpunimi me universitete evropiane; c. 55 marrëveshje me kompani të biznesit; [Ref_045 Marreveshjet Institucionale UPT; Tabelat Permbledhese; takim në institucion]
Kriteri 3. Për realizmin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Zhvillimi i praktikës mësimore është i përfshirë në programin mësimor të programit të studimit Bachelor “Inxhinieri Gjeoinformatikë” vlerësuar në total me 4 ECTS dhe planifikuar të zhvillohet në semestrin e dytë të vitit të dytë (2 ECTS) dhe të tretë (2 ECTS). Në realizimin e saj Departamenti mbështetet në marrëveshjetet e bashkëpunimit që ka nënshkruar me një sërë kompani në fushën e biznesit. [Ref_045 Marreveshjet Institucionale UPT; Tabelat Permbledhese; takim në institucion]. Në mbështetje Fakulteti i Gjeologjisë së Minierave ka nënshkruar edhe një marrëveshje me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë më datë 15.03.2019 e cila fokusohet kryesisht në: a. Kryerjen e praktikave mësimore për studentët e FGJM-së sipas profileve përkatëse; b. Mundësimin e fondeve të mjaftueshm duke specifikuar infrastrukturën dhe pajisjet apo mjetet laboratorike që i nevojiten FMGJ-së;

	c. Bashkëpunimin në ekspertiza kombëtare dhe ndërkombëtare; d. Bashkëpunimin duke përfshirë aktivisht studentët në workshop, konferenca dhe aktivitete të përbashkëta; <i>[Ref_047 Marreveshjet me industrinë dhe institucione]</i> Zhvillimi i praktikës mësimore monitorohet nga drejtuesi i njësisë bazë dhe pedagogët përgjegjës të grupit mësimor kërkimor [Ref.neni 83 në Rregulloren e Brendshme e FMGJ-së; takim me stafin akademik] dhe garatohet nga Koordinator i programit të studimit dhe nga Zv. Dekani për Mësimin. GVJ konstaton një mungesë rregullore në lidhje me zhvillimin e praktikës mësimore dhe bazuar për sa më sipër <i>GVJ propozon që të përfshihet në një dispozitë të veçantë në Rregulloren e programit të studimit për procedurën e zhvillimit të praktikës mësimore, e detyrimet e studentit në lidhje me të dhe vlerësimet përkatëse.</i>			
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Njësia bazë përmes monitorimit të praktikës mësimore në institucionet host ku studentët kryejnë këtë veprimtari analizon në fund të vitit edhe përfitimet përmes këtyre bashkëpunimeve të cilat reflektohen edhe në raportin vjetor që njësia bazë harton në fund të vitit akademik. Drejtoritë përkatëse si Drejtoria e Kërkimit Shkencor dhe Projekteve, Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit dhe Zyra Alumni për specifikat e punës së tyre analizojnë bashkëpunimet me institucione përkatëse. Të dhënat përpunohen në formë statistikore dhe reflektohen në raportin vjetor të FGJM-së. <i>[Ref_046 Rendi i dites së mbledhjes së APA; Ref_044 Raporti i Analizes Mësimore Staf Departament;]</i>			
Konkluzione	<i>FGJM ka të ngritur struktura të cilat zhvillojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimin. Institucioni zhvillon veprimtarinë e tij bazuar në Strategjinë e Zhvillimit dhe në fokus ka forcimin e bashkëpunimit me universitete partnere jashtë vendit, brenda dhe me kompanitë e biznesit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Bazuar në dokumentacion dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se programi i ciklit të parë Bachelor në “Inxhinieri Gjeoinformatikë” është ndërtuar në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit Nr.80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Programi i studimit në shqyrtim ka një kohëzgjatje 3 vite akademike dhe në total ka 180 kredite. Ngarkesa vjetore është 60 kredite me një numër total të lëndëve dhe moduleve 38 (35 lëndë, 1 Praktikë mesimore 1 dhe 2 dhe Punimi i diplomës). Forma e studimit është me kohë të plotë dhe zhvillohet në gjuhën shqipe. Programi i studimit në Kapitullin IV në nenet 14-18 të rregullores së tij përcakton qartë mënyrën e funksionit të programit të studimit të cilin do të propozonim të përmirësohej duke pasqyruar me shumë elemente të programit të studimit dhe mënyrën e vlerësimit të tyre nga ana e studentit. Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Gjeoinformatikë” është program studimi që i referohet nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe mbulohet nga Departamenti Gjeologjia e Zbatuar dhe Gjeoinformatika [Ref_010 Rregullore PS BSc në Inxhinieri Gjeoinformatike; Ref_008 Rregullore e brëndshme e DGJZGJ; Ref_004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies UPT; Ref_011 Plani Mesimor PS BSc në Inxhinieri Gjeoinformatike; Ref_001 Statuti i UPT]. Ky program përmban elementet e nevojshëm (modulet, lëndët dhe kreditet përkatëse për secilin prej tyre, shpërndarjen në çdo semestër), kushtet e pranimi dhe përzgjedhjes, metodat e vlerësimit të studentëve dhe progresi i tyre, kushtet për transferim dhe çdo element detyrues në përputhje me kuadrin ligjor dhe specifikisht me VKM Nr.41 datë 24.01.2018 (i ndryshuar) dhe dispozitat e dhëna në Kreun III-VIII të Rregullores së zhvillimit kurrikular dhe mesimdhënies në UPT [Ref_004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies UPT; Tabelat Permbledhese; Ref_011 Plani Mesimor PS BSc në Inxhinieri Gjeoinformatike].

Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.

Programi i ciklit të parë Bachelor në "Inxhinieri Gjeoinformatikë" është ndërtuar në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit Nr. 10247, datë 04.03.2010, "Për Kuadrin e Kualifikimeve Shqiptare", të ndryshuar. Ky program ofron njohuri dhe zhvillon aftësi dhe kompetenca tek studentët në përfundim të studimeve të tyre në programin Bachelor në Inxhinieri Gjeoinformatikë në përputhje me Nivelin 6 të Kornizës Shqiptare për një formim të thelluar në fushën e gjeologjisë dhe teknologjisë së informacionit përmes analizimit të kuadrit teorik, parimeve dhe përdorimit të pajisjeve dhe programeve

[Ref_004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies UPT; Ref_011 Plani Mesimor PS BSc në Inxhinieri Gjeoinformatike].

GVJ konstaton se përmbajtja e programit të studimit mundëson studentët që në përfundim të studimeve të tyre ata do të kenë fituar njohuri të avancuara në fushën e sisteme informatike, sistemet e gjeoinformacionit, vlerësimin e riskut gjeologjik, gjeologji inxhinierike dhe do të jenë të aftë për zgjidhje konkrete dhe komplekse.

[Ref_011 Plani Mesimor PS BSc në Inxhinieri Gjeoinformatike; takim me studentët; takim me stafin akademik].

Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.

Programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri Gjeoinformatikë" përmban lëndë dhe module të trajtuara gjerësisht në aspektin teorik dhe praktik. GVJ gjen në këtë program studimi një set lëndësh dhe module të cilat formojnë një bazë të gjerë njohurish për studentin dhe marrjen e koncepteve bazë themelore në këtë fushë.

- Disiplina "Lëndë Bazë (A) – Përmban 7 lëndë të formimit të përgjithshëm;
- Disiplina "Lëndë Karakterizuese (B) përmban 20 lëndë duke i ofruar studentit një formim të gjerë teorik dhe praktik në fushën e programimit dhe te gjeologjisë. Përmendim këtu lëndë që japin formim në drejtime:
 - a. Informatikë: Bazë të dhënash, Algoritme dhe strukturë të dhënash, Gjuhe programimi, Programim në ëeb,
 - b. Gjeologji dhe gjeoinformatikë: Gjeologji e përgjithshme, Mineralogji e përgjithshme, Hartografi numerike +GPS, Petrografia magm. dhe metamorfike, Petrografi sedimentare + sedimentologji, Gjeologji strukturore, Stratigrafi,

Gjeokimi, Hidrogjeologji, Bazat e GIS, Gjeologji Inxhinierike;

të cilat janë disa prej lëndëve në këto disiplina të cilat kontribuojnë në një formim të përgjithshëm dhe karakterizues teorik dhe praktik me profilizim në gjeologji.

- Disiplina “Lëndë ndërdisiplinore integruese” (C) përmban 6 lëndë ku 5 janë në fushën e inxhinierisë gjeologjike dhe 1 lëndë “Baza grafike 3D/Programim i avancuar” me 5 ECTS është në fushën e informatikës.
- Disiplina “Lëndë plotësuese” (D) ofron 2 praktika mësimore të cilat zhvillohen në semestrin e dytë përkatësisht në vitin e dytë dhe të tretë (në total 4 ECTS), ofron lëndë gjuhë e huaj (anglisht/italisht) dhe lëndën “Teknologji Informacioni”.
- Disiplina “Detyrimet përmbyllëse” (E) ofron edhe punimin e diplomës ose provim formimi Bachelor me 6 ECTS.

Kategoria	Tipi	ECTS	%	Standardi
A	Lëndë Bazë	36	20%	15-20 %
B	Lëndë karakterizuese	95.5	53 %	50-55 %
C	Lëndë ndërdisiplinore / integruese	27.5	15 %	12-15 %
D	Lëndë plotësuese/ Praktika profesionale	15	8%	10-15 %
E	Detyrime përmbyllëse/ Provimi përfundimtar	6	3%	3-5 %

Nga analiza e programit të studimit, GVJ konstatoi se janë përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët sipas kërkesave të akteve ligjore dhe nënligjore. Duke i ballafaquar dhe përshtatur në përputhje me VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”.

	GVJ në lidhje me këtë element të programit të studimit jep konsideratë si vijon më poshtë: • Ndarja e lëndëve sipas kategorive është në përputhje me standartet e kërkuara për secilën disiplinë; • Bazuar edhe në VKM nr.41 date 24.01.2018 për “Elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” përqindja totale e lëndëve të kategorise “A” + “B” është 73% duke tejkaluar në një masë shumë të vogël (3%) kërkesën e përcaktuar në kornizën ligjore por pa cënuar dhe rënduar ngarkesën e programit mësimor; <i>[Ref_011 Plani Mesimor PS BSc në Inxhinieri Gjeoinformatike; takim me studentët; takim me stafin akademik].</i>
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Programi nuk përmban praktikë profesionale por përmban praktikë mësimore 1 dhe 2 të cilat siç zhvillohen në semestrin e dytë të vitit të dytë dhe të tretë dhe në programin mësimor janë të vendosur në disiplinën “Lëndë plotësuese” (D). Ngarkesa totale e praktikës mësimore është 4 ECTS. Bazuar në programin mësimor për periudhën 2021-2024 praktika 1 dhe 2 mbulojnë përkatësisht lëndët: Praktika Mësimore 1: 1. Petrografia Magmatike dhe Metamorfike (disiplina B) -0.5 ECTS; 2. Petrografi sedimentare – Sedimentologji (disiplina B) – 1 ECTS; 3. Gjeologji strukturore (disiplina B) – 0.5 ECTS; Praktika mësimore 2 përfshin lëndët; 1. Gjeologji krahinore (disiplina C)– 1 ECTS; 2. Gjeologji Inxhinierike (disiplina B)– 0.5 ECTS; 3. Lëndë me zgjedhje (Ekologji e Zbatuar ose Rivelim Gjeologjik) (disiplina C) – 0.5 ECTS; <i>[Ref_011 Plani Mesimor PS BSc në Inxhinieri Gjeoinformatike; takim me studentët; takim me stafin akademik; dokument shtesë: Lëndët që mbulojnë praktikat mësimore 1 dhe 2].</i> Në lidhje me detyrimet përmbyllëse GVJ konstaton në planin mësimor zhvillimin e punimit të temës së diplomës ose provim formimi Bachelor nëse studenti ka një mesatare më të ulët se 6.5 <i>[Ref_113 Kriteri i notës mesatare për procesin e diplomimit; Ref_010 Rregullore PS BSc në Inxhinieri Gjeoinformatike].</i>

Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Regullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT përcakton qartë informacionin në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të pranimi të studentëve. [Ref_004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies UPT]. Kreu VI i saj jep dispozitat në lidhje me transferimet dhe ekuivalentimin e studimeve. Rregullorja e programit të studimit në nenin 9 të Kreut III përcakton: <i>“Në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Gjeoinformatikë regjistrohen persona sipas listave fituese të renditura nga komisioni ad-hoc dhe të miratuara nga Dekani i FTI-se”</i>. Neni 18 në Rregulloren e zhvillimit kurrikular dhe të mesimdhënies në UPT jep informacion për procedurat në lidhje me kuotat e pranimi në programet e studimit. Kushtet e përgjithshme të pranimi në programin e ciklit të parë jepen në nenin 19 të kësaj rregullore ku theksohet se pranohet çdo kandidat i cili ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm ose zotëron një diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar nga ministria përgjegjëse për arsimin e lartë”. Pika 3 e këtij neni ja atribuon njësisë bazë përcaktimin e kriterëve të veçanta për programin e studimit. [Ref_004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies UPT; Ref_010 Rregullore PS BSc në Inxhinieri Gjeoinformatike].
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtësë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	UPT nuk ofron program tjetër studimi në të njëjtën fushë dhe me të njëjtën emërtësë. Nuk ofrohet asnjë program tjetër me të njëjtën emërtësë. është unik në RSH. [Ref_004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies]
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	GVJ konstaton se kodifikimi i lëndëve është zhvilluar bazuar në VKM nr.310 datë 11.05.2022 dhe Urdhërit të MAS nr.31 datë 15.11.2022 [Ref_023 Syllabuset e lendeve ne PS Bsc Inxhinieri Gjeoinformatike; Ref_011 Plani Mesimor PS BSc në Inxhinieri Gjeoinformatike].
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit	NA

të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.				
Konkluzione	<i>Programi i studimit i korresponдон Nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Programi i studimit ka objektiva të qartë në drejtim të përgatitjes së studentit. Programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri Gjeoinformatikë" përmban lëndë dhe module të trajtuara gjerësisht në aspektin teorik dhe praktik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	FGJM përmbush detyrimet ligjore, referuar Kreut V të Ligjit për Arsimin e Lartë nr.80/2015 për "Organizimin akademik dhe administrative i IAL". Referuar Rregullores së FGJM-së, Kreu III "Organizimi akademik dhe administrativ i FGJM-së", neni 9 përcakton organet kolegjiale drejtuese të FTI-së përkatësisht Asambleja e Personelit Akademik, Dekanati dhe Komisionet e Përhershme duke përshkruar qartë detyrat dhe përgjegjësitë në nenin 10-12 të tij. Nenet 12 e në vijim të Rregullores së Brendshme të FGJM-së përcaktojnë edhe autoritet drejtuese të kësaj njësie kryesore: 1. Dekani (neni 19); 2. Zëvendës-Dekanët (neni 23) 3. Zëvendës-Dekani për anën mësimore (neni 24,25) 4. Zëvendës-Ddekani për anën kërkimore – shkencore (neni 24,25) 5. Drejtuesi i njësisë bazë (neni 25); [Ref_006 Rregullore e brendshme FGJM_2020]. Organizimi i strukturës akademike të FGJM-së është në përputhje të plotë edhe me Statutin e UPT-së përkatësisht Kreu III i tij (Autoritetet Kolegjiale dhe Drejtuese Akademike). <i>Ref_001 Statuti i UPT</i>]. Fakulteti i Gjeologjisë së Minierave përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik. Ky fakultet angazhon një staf me eksperiencë dhe grada

shkencore. Të dhënat statistikore tregojnë një qëndrueshmëri në vite të stafit PAE të punësuar në programet e studimit. FGJM i përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë për vitet akademike:

TOTAL (2023-2024)	49	(12) Prof. Dr.	33	(5) Prof. Dr.	13 (P. ndihmes akademik)	95
		(8) Prof. Asoc.		(4) prof. Asoc. Dr.		
		(21) Dr.		(6) Dr.		
		(1) Dr. proc.		(0) Dr. proces		
		(7) Msc		(18) Msc.		
TOTAL (2022-2023)	55	(17) Prof. Dr.	28	(2) Prof. Dr.	13 (P. ndihmes akademik)	96
		(8) Prof. Asoc.		(4) prof. Asoc. Dr.		
		(23) Dr.		(4) Dr.		
		(1) Dr. proc.		(0) Dr. proces		
		(6) Msc		(18) Msc.		
TOTAL (2021-2022)	53	(17) Prof. Dr.	37	(2) Prof. Dr.	13 (P. ndihmes akademik)	103
		(8) Prof. Asoc.		(6) prof. Asoc. Dr.		
		(10) Dr.		(6) Dr.		
		(0) Dr. proc.		(0) Dr. proces		
		(0) Msc		(23) Msc.		

Departamenti Gjeologjia e Zbatuar dhe Gjeoinformatika (DGJZGJ) zotëron një staf që zë 22.1% të numrit total të stafit akademik të FGJM-së. GVJ konstaton se DGJZGJ ka ruajtur në vite numrin e tij duke përmbushur standartet ligjore. Tabela më poshtë jep një pasqyrë të stafit akademik të angazhuar në këtë departament.

Departamenti Gjeologjia e Zbatuar dhe Gjeoinformatika						
TOTAL (2023-2024)	14	(0) Prof. Dr.	4	(0) Prof. Dr.	3 (P. ndihmes akademik)	21
		(4) Prof. Asoc.		(1) Prof. Asoc. Dr.		
		(21) Dr.		(0) Dr.		
		(1) Dr. proc.		(0) Dr. proces		
		(7) Msc		(3) Msc.		
TOTAL (2022-2023)	17	(2) Prof. Dr.	3	(0) Prof. Dr.	3 (P. ndihmes akademik)	23
		(4) Prof. Asoc.		(0) Prof. Asoc. Dr.		
		(11) Dr.		(0) Dr.		
		(0) Dr. proc.		(0) Dr. proces		
		(0) Msc		(3) Msc.		
TOTAL (2021-2022)	16	(2) Prof. Dr.	6	(0) Prof. Dr.	3 (P. ndihmes akademik)	25
		(3) Prof. Asoc.		(0) Prof. Asoc. Dr.		
		(6) Dr.		(2) Dr.		
		(0) Dr. proc.		(0) Dr. proces		
		(5) Msc		(4) Msc.		

GVJ shqyrtoi me vëmendje dokumentacionin e paraqitur nga institucioni dhe verifikimit të tij në platformën elektronike të ASCAL dhe konkludon si vijon më poshtë:

	• Universiteti Politeknik i Tiranës si IAL në Republikën e Shqipërisë i është akorduar akreditimi institucional me Vendim BA Nr. 01 datë 07.01.2022, me kohëzgjatje 6 vite akademike, afati vlefshmërisë deri më 06.01.2028 [platforma elektronike ASCAL]. • Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Gjeoinformatikë” zhvillon për herë të parë procesin e akreditimit në nivel programi; • Departamenti Gjeologjia e Zbatuar dhe Gjeoinformatika përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin sipas përcaktimeve në ligjin 80/2015;
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	FGJM përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit ndihmës - akademik. Për periudhën 3 vjeçare (2021-2024) në çdo vit janë angazhuar 13 personel ndihmës akademik ndërsa departamenti i Gjeologjisë së Zbatuar dhe Gjeoinformatikës ka angazhuar 3 veta në këtë drejtim [Ref. Tabelë përmbledhëse]. Takimet në institucion dëshmuar për një personel ndihmës akademik me eksperiencë dhe përvojë duke kontribuar në realizimin e praktikave GVJ konstaton nga evidencat e orëve laboratorike [takime në institucion].
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	GVJ konstaton nga evidencat e paraqitur dhe nga takimet në institucion rolin e KPS-së strukturë e cila është përgjegjëse për menaxhimin dhe organizimin e programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Gjeoinformatikë” [takime në institucion; Ref_020 Vendimi i DGJZGJ Për ngritjen e KPS]. GVJ u njoh me rolin dhe funksionin e koordinatorit të programit i cili emërohet nga KPS bazuar në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular të Mesimdhënies dhe Vendimin të DGJS-së. Në RVB janë përshkruar qartë përberja e KPS dhe GVJ gjatë takimeve me stafin akademik u njoh me rolin e tyre në drejtim të organizimit të praktikave mësimore, ndihmesës së studentëve në lidhje me procesin mëimor dhe angazhimin e tyre në aktivitete të organizuara në fakultet [takime në institucion; Ref_020 Vendimi i DGJZGJ Për ngritjen e KPS; RVB standarti II.2, kriteri 3; Ref_004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies UPT].
Konkluzione	GVJ evidenton se programi i studimit ka një plan mësimor të qartë. Programi i studimit nuk është program i akredituar dhe tashmë është në proces të vlerësimit për herë të parë të tij. Programi i studimit angazhon një staf akademik me përvojë dhe eksperiencë. Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular të Mësimi përcakton edhe Koordinatorin për mësimin.

Shkalla e përmbushjes së standardit			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	FGJM dhe DGJZGJ disponojnë të gjithë informacionet e nevojshme për organizimin dhe mbarëvajtjen e programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Gjeoinformatikë”. Dokumentat bazë që japin informacionin e nevojshëm për mënyrën e funksionimit të programit të studimit janë si vijojnë më poshtë: - Rregullorja e FGJM-së [Ref_006 Rregullore e brendshme FGJM_2020]; - Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT [Ref_004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies UPT]; - Struktura organizative e njësisë bazë dhe Rregullorja e saj [Ref_005 Organigrama e UPT; Ref_008 Rregullore e brendshme e DGJZGJ]; - Vendime të Asamblesë Akademike dhe çdo vendim të miratuar në Senatin Akademik për programin mësimor; - Plani mësimor i programit të studimit [Ref_011 Plani Mesimor PS BSc në Inxhinieri Gjeoinformatike]; - Rregullorja e programit të studimit [Ref_010 Rregullore PS BSc në Inxhinieri Gjeoinformatike]; - Syllabuset për çdo lëndë të rifreskuara dhe rishikuara në fillim të çdo viti akademik dhe të aprovuara në DGJZGJ [Ref_023 Syllabuset e lendeve ne PS Bsc Inxhinieri Gjeoinformatike]; FGJM ndjek një procedurë të caktuar në lidhje me arshivimin dhe protokollimin e çdo shkrese zyrtare që buron nga DGJZGJ dhe dokumentacioni bazë ruhet në arshivën e FGJM-së. Informacioni i nevojshëm në lidhje me programin mësimor është i aksesueshëm edhe në www.upt.al e cila tashme është aktive.
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra,	Organizimi i programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Gjeoinformatikë” dhe lëndët e ofruara janë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi përcaktuar nga MASR [Ref.VKM.nr.41 date 24.01.2018]. Referuar programit të studimit ndarja sipas kategorive në të cilat përfshihen lëndet dhe modulet është si vijon më poshtë: - Kategoria A: 36 ECTS; - Kategoria B: 95.5 ECTS;

ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.

- Kategoria C: 27.5 ECTS;
- Kategoria D: 15 ECTS;
- Kategoria E: 6 ECTS;

Studimet në programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Gjeoinformatikë” organizohen në lëndë dhe module dhe vlerësohen sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Numri i lëndëve në total është 35 duke shtuar praktikën mësimore dhe temën e diplomës shkon në një total 38. Format e testimit janë provim në 35 lëndë, praktika mësimore 1 dhe 2 është me relacion dhe diploma është me përgatitje të temës nga ana e studentit. Sipas planit mësimor në semestrin e katërt dhe të gjashtë studenti frekuenton Praktikën Mësimore (2 ECTS secila) dhe në fund të këtij semestri pasi ka mbyllur të gjithë detyrimet përgatit temën e diplomës e cila është 6 ECTS. [Ref_011 Plani Mesimor PS BSc në Inxhinieri Gjeoinformatike, tabelë përmbledhëse].

Programi Bachelor në “Inxhinieri Gjeoinformatikë” ka 35 lëndë pa përfshirë Praktikën Mësimore dhe temën e diplomës/ provim formimi. Në total janë 35 forma testimi me provim përcaktuar në nenin 17 të Rregullores së Programit të Studimit. Lëndët janë ndarë sipas semestrave dhe krediteve për të balancuar peshën e oreve në auditor. Programi zgjat 6 semestra. Neni 14 në Rregulloren e Programit të Studimit përcakton se programi i studimit zgjat tre vite akademike dhe kohëzgjatja maksimale nuk mund të jetë më shumë se dyfishi i kohëzgjatjes normale të tij

[Ref_010 Rregullore PS BSc në Inxhinieri Gjeoinformatike].

Semestri I	32 ECTS	(6 lëndë)
Semestri II	28 ECTS	(6 lëndë)
Semestri III	30ECTS	(6 lëndë)
Semestri IV	30 ECTS	(5 lëndë dhe praktikw mësimore 1)
Semestri V	30.5 ECTS	(6 lëndë)
Semestri VI	29.5 ECTS	(5 lëndë, praktika mësimore dhe tema e diplomës)

Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.

Rregullorja e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT përcakton qartë informacionin në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të pranimit të studentëve. [Ref.12. Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT]. Kreu VI i saj jep dispozitat në lidhje me transferimet dhe ekuivalentimin e studimeve. Rregullorja e programit të studimit në nenin 9 të Kreut III përcakton: “Programi i Studimit Bachelor në Inxhinieri Gjeoinformatikë ka si kriter kryesor pranimi Maturën Shtetërore, kriteret e parashikuara në Ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” si edhe

gjithë akteve nënligjore apo udhëzimeve dhe urdhërave të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve.”.

Neni 18 në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe të Mësidhënies në UPT jep informacion për procedurat në lidhje me kuotat e pranimit në programet e studimit. Kushtet e përgjithshme të pranimit në programin e ciklit të parë jepen në nenin 19 të kësaj rregullore ku theksohet se pranohet çdo kandidat i cili ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm ose zotëron një diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar nga ministria përgjegjëse për arsimin e lartë”. Pika 3 e këtij neni ja atribuon njësisë bazë përcaktimin e kriterëve të veçanta për programin e studimit. Bazuar për sa më sipër GVJ nuk gjeti evidencë të kushteve të veçanta të pranimit të shprehur në rregulloren e programit të studimit.

[Ref_004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies UPT; Ref_006 Rregullore e brendshme FGJM_2020; Ref_008 Rregullore e brendshme e DGJZGJ; Ref_010 Rregullore PS BSc në Inxhinieri Gjeoinformatike].

Kushtet e veçanta të pranimit burojnë nga njësia bazë dhe miratohen me vendim të Senatit Akademik [Ref_026 Praktika e miratimit të kuotave të pranimit në FGJM]. Për vitin 2022-2023 përzgjedhja e kandidatëve është bërë bazuar në masën 70% të notës mesatare të shkollës së mesme, bazuar në kriterin e notës mesatare të përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave për vitin akademik 2022-2023 dhe në masën 30% mesatare aritmetike të peshuara të tre lëndëve: Matematikë, Fizikë dhe Kimi në të gjitha vitet e shkollës së mesme bazuar në formulën e publikuar dhe njohur [Ref_027 Praktika e miratimit të kriterëve të pranimit në FGJM].

DGJZGJ ka ruajtur kuotat e regjistrimit të studentëve në masën 60 kandidatë për çdo vit akademik [Ref_026 Praktika e miratimit të kuotave të pranimit në FGJM].

Numri i studentëve të regjistruar për herë të parë në programin e studimit janë pasqyruar në tabelën mëposhtë. Të dhënat i referohen tabelës përmbledhëse dhe të dhënave të gjetur gjatë vizitës në sekretarinë mësimore.

Sipa viteve akademike	Të regjistruar për herë të parë	Nota mesatare në hyrje	Të ç’regjistruar	Total
2019-2020	50		7	43
2020-2021	48		10	38
2021-2022	50	7.89	4	46
2022-2023	37	7.67	1	36
2023-2024	22	8	-	22

	Total	207	7.85	22	185
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikë, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Për programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Gjeoinformatikë”, janë paraqitur programet e lëndëve të cilat janë të klasifikuara në kategori A, B, C, D dhe E. Programi i lëndës jep informacion mbi lektorin/lektorët që do të zhvillojnë modulin/lëndën dhe semestrin kur zhvillohet, tipologjinë e modulit/lëndës në leksione , në seminare dhe në laboratorë, njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti; kohëzgjatjen e modulit; kreditet ECTS; objektivat e modulit/lëndës; elementët e mësimdhënies; detyrimet e studentit; metodat e vlerësimit dhe literaturën. GVJ është i mendimit që programi përmban elementët e kërkuar nga VKM Nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë”, si dhe VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë” [Ref_023 Syllabuset e lendeve ne PS Bsc Inxhinieri Gjeoinformatike]				
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	GVJ konstaton një praktikë të duhur dhe të rregullt në lidhje me miratimin e planeve mësimore për çdo vit akademik. Në zbatim të kësaj procedure dhe në përputhshmëri me Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular të Mësimdhënies, neni 12, njësia bazë në muaji Prill diskuton dhe aprovon planin mësimor për vitin e ardhshëm akademik. Planet mësimore kërkojnë të jenë në përputhje edhe me kornizën ligjore në fuqi dhe me kërkesat e VKM nr. 41 datë 24.01.20218 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” dhe VKM nr.879 datë 18.12.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.41 datë 24.01.2018” [Ref_040 Praktika e miratimit te planeve mesimore; Ref_004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies UPT]. Planet mësimore dërgohen nga Dekanati i FMGJ në Drejtorinë e Kurrikulave në UPT të cilat shqyrtojnë dhe miratojnë ndryshimet të cilat më pas miratohen në Senatin Akademik. GVJ u njoh me praktika të ndryshimit në masën 20% gjatë takimit të zhvilluar me stafin akademik. GVJ u njoh edhe me praktikë të refuzimit nga Dekanati i FMGJ-së të propozimit të bërë në planin mësimor 2021-2022 nga njësia bazë për heqjen e lëndës “Informatikë” dhe zëvendësimit të saj me “Hyrje në ekonomik dhe menaxhim projekti”. Përmes urdhrin nr. 02 datë 12.10.2021 është bërë nga Dekani i FMGJ-së anulimi i ndryshimeve të propozuara në planin mësimor duke e konsideruar këtë propozim si të pa studjuar mirë dhe duke argumentuar rëndësinë e lëndës “Informatikë”. Në këtë				

	vendim pika 2 dhe 3 konsiderojnë njëkohësisht edhe marrjen e masave për hartimin e një syllabusi të ri për lëndën “Informatikë” dhe shfrytëzimin e burimeve njerëzore brenda grupit për sigurimin e saj, duke shprehur qartë nga ana institucionale zhvillimin e një praktike të qartë nga ana e FMGJ-së edhe korrektësinë në zbatim të proceduravë për përmirësim të programeve dhe verifikimeve të propozimeve të ardhura nga njësia bazë [Ref_040 Praktika e miratimit të planeve mesimore; Ref_043 Praktika e parashikimit të ngarkesës mesimore në departament].			
Konkluzione	GVJ konstaton se FGJM dhe DGJZGJI disponojnë të gjithë informacionet e nevojshme për organizimin dhe vënien në funksionim të programit të studimit të ciklit të parë “Inxhinieri Gjeoinformatikë”. Organizimi i programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Gjeoinformatikë”, si dhe lëndët e ofruara në të janë në përputhje me kërkesat e një programi të ciklit të parë të studimeve, siç janë të përcaktura në VKM nr. 41, 24.01.2018. Programi krijon mundësi në thellimin e njohurive në përputhje me kriteret e vendosura. Lëndët janë të ndara sipas semestrave dhe krediteve për të balancuar peshën e orëve në auditor. Programi i studimit zgjat tre vite m dhe çdo vit akademik ka 60 ECTS. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj. Programi mësimor nuk ka pësuar ndryshime që tejkalojnë masën mbi 20%.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënës dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimet në institucion, GVJ është i mendimit se përmbajtja e veprimtarive dhe shpërndarja e lëndëve mundësojnë, njohuri, aftësi dhe kompetenca të cilat garantojnë formimin e nevojshëm për punësim të studentëve. Përmbajtja e programit mësimor mundëson studentët të thellojnë njohuritë në fushën e inxhinierisë kompjuterike dhe programimit. Ngarkesa mësimore ka një shpërndarje të drejtë të orëve laboratorike, seminareve, detyra/projekte kursi.

mëtejshme dhe/ose
punësimin e studentëve.

Programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri Gjeoinformatikë" është një program i konceptuar që të kombinojë pjesën teorike me atë praktike. Konkretisht në këtë program zhvillohen:

- Orë faktike: 2284.5
- Orë në leksione: 1098
- Orë ushtrime: 812
- Orë për detyra kursi/projekte: 48.5
- Orë laboratorike: 196
- Orë praktikë lëndore/mësimore dhe teme diplome: 100

Programi mësimor një vëmendje të veçantë i jep pjesës së ushtrimeve, orëve laboratorike dhe projekteve të kursit. Në total vërejmë 1098 orë leksione dhe 1156.5 orë praktikë duke demonstruar që kjo e fundit prevalon [Ref_011 Plani Mësimor PS BSc në Inxhinieri Gjeoinformatike]. Bazuar në raportin e lëndëve Informatikë dhe Gjeologji konstatohet se kjo e fundit dominon. **Propozojmë që programi duhet të forcojë kompetencat e studentit edhe në fushën e informatikës duke i siguruar një specializim më të mirë edhe në këtë fushë.**

Kriteri 2.

Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.

GVJ bazuar edhe në standartet më sipër konstaton se programi mësimor Bachelor në "Inxhinieri Gjeoinformatikë" është i hartuar për të balancuar ngarkesën teorike me praktikën në një raport 48%: 52%. Ky ekuilibër është evident duke garantuar në fund të çdo viti akademik plotësimin e 60 ECTS. Programi i studimit, lëndët, shpërndarja në vite dhe semestra, vlerësimi në kredite dhe orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit.

Viti	Lëndet për secilen kategori				
	"A"	"B"	"C"	"D"	"E"
I	6	4	-	2	-
II	1	10	1	Praktike mesimore 1	-
III	-	6	5	Praktike mesimore 2	Punim diplome/provim formimi
Total	7	20	6	4	1

Semestri	Ngarkesa javore	
	Leksione	Seminare
I	14.6	15.4
II	13.3	13.4
III	13.3	13.8
IV	16	12.8
V	13.3	13.8

	GVJ konkludon që programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Gjeoinformatikë” përmbush të gjithë standartet, normat dhe dispozita ligjore të përcaktuara nga MAS për organizimin e tij, për shpërndarjen e krediteve, orëve brenda dhe jashtë saj auditorit, për zhvillimin e praktikës mësimore dhe profesionale dhe mbrojtjen e temës së diplomes [Ref_011 Plani Mesimor PS BSc në Inxhinieri Gjeoinformatike; Ref_023 Syllabuset e lendeve ne PS Bsc Inxhinieri Gjeoinformatike].			
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	GVJ është i mendimit se në përgjithësi struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit Bachelor, unik në Republikën e Shqipërisë dhe e përafërt me programe të ngjashme kryesisht nga universitetet politklike në Evropë [takim me ish-Dekanin e FMGJ-së, takim me shefin e njësisë bazë]. Duke konsideruar që është unik në vend hartimi i përmbajtjes së këtij programi ka sjellë praktikat më të mira të programeve të ngjashme me të në Evropë dhe jashtë saj. Programi mësimor ndonëse ka qëllimin kryesor aftësimin në praktikë të studentit nuk ka anashkuar asnjëherë kuadrin teorik që është edhe baza e njohjes së koncepteve themelore dhe më pas vijimin e zbatimit të tij në praktikë përmes studimit të rasteve kontrete. Shembuj të shumtë u sollën në takimin e zhvilluar me stafin akademik në lidhje me rastet studimore të kryera gjatë praktikave mësimore duke aftësuar studentët të njihen me shembuj konkretë dhe të jenë të aftë të kryejë analiza dhe të japin mendime konkrete në lidhje me to. Përmbajtja e programit dhe kompetencat që studenti fiton e mundësojnë atë të thellojë njohuritë në programin master profesional qe ofrohet nga kjo njësi bazë në të njëjtin drejtim [takim me stafin akademik].			
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis pjesës teorike dhe praktikës mundësojnë arritjen e objektivave formuese të përcaktuara në këtë program studimi. Gjithashtu vlerësimi me kredite ECTS lejon transferimin e studimeve, mobilitetin dhe punësimin e studentëve në përfundim të programit të studimit. Në lidhje me mobilitetin e studentëve konstatojmë një angazhim shumë të dobët në këtë drejtim. Të dhënat në lidhje me punësimin janë të dobta. Ndonëse në RVB dhe në takime u shprehën mendime pozitive tabela më poshtë jep një pasqyrë konkrete të punësimit të studentëve duke pasqyruar problematikën në këtë fushë.			
	Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Gjeoinformatikë”	Numri total i studentëve të diplomuar	Numri total i studentëve të punësuar në	Numri total i studentëve të punësuar jo në

			përputhje me diplomën	perputhje me diplomën	
		2021-2024	72	9	7
		%		13%	9.7%
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	GVJ u njoh me programet lëndore (syllabuset) e paraqitura nga institucioni. Diskutime në lidhje me to u zhvilluan edhe gjatë takimeve me stafin akademik dhe përfaqësues të institucionit. Për programin e studimit të ciklit të parë “Inxhinieri Gjeoinformatikë” institucioni ka paraqitur të gjithë syllabuset me detajimet përkatëse të tyre. Në përgjithësi institucioni i përmbahet formatit të kërkuar nga institucionet përkatëse të arsimit. Syllabuset përmbajnë elementët e nevojshëm qe japin një përshkrim të përmbajtjes së lëndës dhe veprimtarisë që do të zhvillohet me studentin.				
	Konkretisht dallojmë:				
	1. Tipologjinë e lëndës, kodin, vitin akademik, semestri në të cilën zhvillohet lenda, titullari dhe kontaktet me të; 2. Një përshkrim tabular jepet për aktivitetin mësimor. Në syllabus specifikohen qartë orët e leksioneve, seminareve, praktikave laboratorike, detyrat/projekte kurse duke specifikuar edhe ngarkesat në auditor, jashtë tij dhe ngarkesën totale; 3. Njohuritë paraprake; 4. Objektivat e lëndës; 5. Njohuritë dhe aftësitë që përftohen nga përvetësimi i lëndës; 6. Përshkrim i detajuar jepet në lidhje me leksionet, përmbajtjen dhe tematikën dhe orët përkatëse. Përshkrim i qartë jepet edhe për orët e seminareve, orët laboratorike duke tejkaluar edhe VKM nr.41 e cila në formatin e saj nuk e kërkon një detajim të tillë. 7. Kontrolltet gjatë semestrit të zhvillimit të lëndës; 8. Parakushtet për hyrjen në provimin e lëndës; 9. Provimi i lëndës dhe mënyra e organizimit të tij në përshtatje me specifikat e lëndës; 10. Literatura bazë dhe e rekomanduar .Në këtë të fundit konstatojmë që në disa lëndë literatura bazë është pak e vjetër. Nga diskutimet me stafin akademik u theksua nga ana e tyre që ka mungesë botimesh dhe specifikat në këtë fushë e kërkojnë që shpeshherë ti referohen edhe literaturës së vjetër [takim me stafin akademik].				

	[Ref_023 Syllabuset e lendeve ne PS Bsc Inxhinieri Gjeoinformatike]			
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Gjeoinformatikë”, i vlerësuar në përmbajtje nga GVJ, garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për një program studimi të ciklit të parë. Nga takimet me studentët rezulton se realizimi faktik i programit të studimit është brenda pritshmërive të tyre [Ev. Takim me studentët].			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	FMGJ ofron 6 programe Master i Shkencave dhe Master Profesional në fushën e inxhinierisë gjeoinformatikë dhe të ngjashme me të. Përmbajtja e programit mundëson studentët të thellojnë njohuritë e tyre në programe të mëtejshme [Ref_010 Rregullore PS BSc në Inxhinieri Gjeoinformatike].			
Konkluzione	GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Gjeoinformatikë” është një program i cili kombinon pjesën teorike me atë praktike. Shpërndarja e krediteve është e njëjtë për të gjithë lëndët. Programi mësimor ka një strukturë të qartë dhe të mirëorganizuar të lëndëve. Programi mësimor është hartuar me objektiva të qarta dhe pritshmëri për studentin në fund të diplomimit të tij. Programi i Studimit, lëndët-modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit. Vlerësimi me kredite ECTS lejon transferimin e studimeve, mobilitetin dhe punësimin e studentëve në përfundim të programit të studimit. UPT përcakton qartë në rregullore kriteret dhe procedurat në transferimin e studimeve. GVJ konstaton se punësimi i studentëve në përfundim të studimeve të tyre është shumë i ulët.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me	Njësia bazë bën përmirësime të vazhdueshme të programit në masën 20%. Ndryshimet janë kryesisht në përmbajtjen e lëndës duke vendosur tema të reja [takim me stafin akademik]. Institucioni ndjek një procedurë të qartë në lidhje me

kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	përmirësimet në programin mësimor. Ndryshimet në përmbajtje reflektohen në syllabuse ndërsa plani mësimor reflekton ndryshimet në lëndë [Ref_040 Praktika e miratimit të planeve mesimore]. GVJ u njoh me praktika të miratimit të planit mësimor dhe vendime për miratimin ose refuzimin e propozimeve të ardhur nga njësia bazë për programin mësimor. <u>GVJ nuk gjeti evidencë të ndryshimeve si reflektim i mendimit të institucioneve partnere. Mungesa e praktikës profesionale dhe zhvillimi vetëm i praktikës mësimore bën që stafi akademik të jetë i shkëputur me kompanitë e biznesit dhe përthithjen e mendimit të tyre [takim me stafin akademik, Ref_011 Planit Mesimor PS BSc në Inxhinieri Gjeoinformatike].</u>			
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Plani mësimor ka pësuar ndryshime të vazhdueshme që kanë ardhur si pasojë e kuadrit ligjor [takim me stafin akademik, takim me përfaqësues të Drejtorisë së Kurrikulave në UPT]. Studentët përfshihen në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit. Kjo realizohet nëpërmjet marrjes së mendimit të tyre që realizohet nëpërmjet anketimeve të kryera [Ref_060 Anketimi Studentor - Pyetësi dhe Raporti]. Studentët janë pjesë e dhënies së mendimit të tyre në lidhje me përmbajtjen e programit mësimor përmes anketimeve që institucioni zhvillon në fund të çdo semestri [takim me studentet]. <u>GVJ nuk gjeti evidenca të qarta në lidhje me reflektimin e mendimit të studentëve në përmirësimin e programit mësimor.</u>			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Departamenti i Gjeologjisë së Zbatuar dhe Gjeoinformatikës bashkëpunon me grupet e interesit për të garantuar cilësinë e programit të studimit. Konkretisht GVJ përmes evidencave konstaton: 1. Partnership me universitetet të huaja në Evropë [Ref_045 Marrëveshjet Institucionale UPT]. 2. Marrëveshje Bashkëpunimi të lidhur me universitete [tabelë përmbledhëse]; • Bashkëpunime në kuadër të programit Erasmus+;			
Konkluzione	GVJ evidenton se njësia bazë zhvillon punë në drejtim të përmirësimit të programit mësimor. Programi ka pësuar ndryshime në masën 20%. Studentët janë pjesë e anketimeve ku japin mendimin e tyre në lidhje me procesin mësimor.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	----------

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Referuar ligjit në fuqi, akteve nënligjore, Rregullores së Programit të Studimit si dhe planit mësimor, format e mësimdhënies janë leksionet, ushtrimet, seminarët, laboratorët, detyrat e kursit / projekt kursi, praktika mësimore 1 dhe 2, projekt diploma [Ref_011 Plani Mesimor PS BSc në Inxhinieri Gjeoinformatike; Ref_023 Syllabusët e lendeve në PS Bsc Inxhinieri Gjeoinformatike]. Neni 25 në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT përcakton format e mësimdhënies dhe kontrollit të dijeve. Baza e realizimit të procesit mësimor në auditor është ora mësimore. Një orë mësimore ka kohëzgjatjen 60 minuta. Ndër format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve janë format klasike të mësimdhënies të cilat ndërthuren me metoda të ndryshme bashkëkohore [takim me stafin akademik]. Nga diskutimi me personelin akademik dhe studentët e programit, GVJ u informua për mënyrën e zhvillimit të lëndëve të ndryshme dhe në mënyrë të veçantë për peshën e elementëve formues të parashikuar në secilën lëndë. U konstatua se personeli akademik i kushton një rëndësi të veçantë realizimit të detyrave apo projekteve të kursit [takim me stafin akademik].
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Për t'ju përgjigjur diversitetit dhe kërkesave të studentëve, personeli akademik mban kontakt të vazhdueshëm me ta nëpërmjet Koordinatorit të Programit të Studimit dhe KPS-së si dhe në çdo lëndë mundësohet komunikimi me studentët jo vetëm gjatë realizimit të procesit mësimor në auditor, por edhe jashtë auditorit nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë, në rrugë elektronike (e-mail, etj) [takime në institucion]. Në takimin me stafin akademik shembuj u sollën në lidhje me format e mësimdhënies dhe përmirësimet e tyre. Konkretisht një fokus i veçantë i është dhënë përdorimit të imazherisë duke konsideruar specifikat në këto lëndë. Një fokus i veçantë i është dhënë edhe trajtimit të kuadrit teorik duke e bërë atë të përshtatshme me praktikën [takim me stafin akademik].
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike	GVJ konstatoi se për të mundësuar përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve, institucioni ka vepruar në disa drejtime si: Në përmirësimin e infrastrukturës së mësimdhënies,

dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	duke ofruar auditorë të pajisur me mjete audio-vizive të mësimdhënies. Rikonstruksioni i ndërtesës krijon edhe mundësi të zgjerimit dhe përmirësimit të gjendjes së sallave të leksioneve, seminareve dhe laboratorëve duke i bërë ato të reja dhe bashkëkohore [vizitë në institucion]. Nëpërmjet krijimit të oportuniteteve për stafin akademik nëpërmjet mobiliteteve të ndryshme në institucione të arsimit të lartë jashtë vendit për të përsosur metodat e mësimdhënies kryesisht ne programet Erasmus+ dhe COST. GVJ është i vetëdijshëm që kemi të bëjmë me fonde publike ku investimi në këtë drejtim është pak i vështirë si pasojë e kornizës ligjore në fuqi [Ref. Takime në institucion]
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Personeli akademik që angazhohet në këtë program studimi mbart eksperiencë në fushën inxhinierike. Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij, gjë e cila mund të shihet edhe në kurrikulumet e tyre në të cilat janë përmendur specializimet, gradat, titujt, etj [Ref_023 Syllabuset e lendeve ne PS Bsc Inxhinieri Gjeoinformatike; Ref_024 CV e stafit akademik; tabelë permbledhëse]. Programi mësimor mbulohet nga stafi akademik Departamenti i Gjeologjisë së Zbatuar dhe Gjeonformatikës dhe nga departamente të fakulteteve të tjera në UPT. Konkretisht lëndët bazë si Matematike, Kimi, Fizike mbulohen nga FMIF. Lëndët bazë të gjeologjisë mbulohen nga DGJZGJI dhe departamentet e tjera të Fakultetit të Gjeologjisë Minerare. Konstatohet se kategoria Prof.Dr dhe Prof. Asoc. Dr mbulon lëndët kryesore të gjeologjisë ndersa kategoria Prof. Asoc. Dr dhe Dr mbulojnë lëndët në fushën e Informatikës. Për vitin 2023-2024 janë angazhuar edhe 3 personel asistent Lektor të kategorisë MSc kryesisht në dhënien e praktikave dhe seminareve. Departamenti i Gjeologjisë së Zbatuar dhe Gjeoinformatikës përgjatë periudhës 2021-2024 ka mbuluar 11 lëndë ndersa pjesa tjetër është zhvilluar nga njësitë e tjera të FMGJ dhe të UPT-së. Bazuar në takime dhe në evidencat e paraqitura stafi akademik është me eksperiencë dhe i motivuar në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor [Ref_023 Syllabuset e lendeve ne PS Bsc Inxhinieri Gjeoinformatike; Ref_024 CV e stafit akademik; tabelë permbledhëse]. Stafi akademik është i njohur edhe në fushën kërkimore shkencore përmes një numri të gjerë publikimesh në revista shencore, pjesëmarrjes në konfereca dhe trajnime dhe përmes punës së tyre

	edhe jashtë institucionit si konsulente në kompani të njohura [tabele përmbledhëse].
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	GVJ konstatoi se metodat e mësimdhënies janë objekt i diskutimeve dhe vlerësimeve si nga vetë personeli akademik për lëndët që mbulojnë ashtu edhe nga studentët (pyetsorit të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies së lëndëve të programit të studimit) si dhe nga drejtuesi i njësisë bazë [takim me stafin akademik, takim me shefin e DGJZGJI]. Në mënyrë të veçantë përpunimi i të dhënave të pyetsorit të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies së lëndëve dhe për stafin akademik për çdo program studimi i cili plotësohet në fund të çdo semestri shërben si bazë për përmirësime të mëtejshme [Ref_044 Raporti i Analizes Mesimore Staf Departament; Ref_101 Pyetësor i zhvilluar nga pedagogu i lëndës drejt studentëve].
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	UPT ka ngritur mekanizma për monitorimin dhe vlerësimin e procesit të mësimdhënies në mënyrë periodike. GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga institucioni në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin e procesit mësimor nga ana e Institucionit konstaton si vijon më poshtë strukturat përgjegjëse: - Drejtuesi i Njësisë Bazë koordinon, kontrollon dhe menaxhon procesin mësimor. Në mënyrë periodike ai përgatit raportet vjetore të punës mësimore, kërkimit shkencor dhe zhvillimit të DGJZGJI, mbështetur në raportet e grupeve mësimore-kërkimore [Ref_006 Rregullore e brendshme FGJM_2020; Ref_004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies UPT; Ref_008 Rregullore e brendshme e DGJZGJ; Ref_073 Raport i aktivitetit mësimor në nivel njësisish dhe universiteti.]; - Në drejtim të sigurimit të brendshëm të cilësisë është ngritur në nivel universiteti Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, dhe në nivel FGJM është ngritur Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. GVJ në takimin me përfaqësues të kësaj drejtorie u njoh me detyrat dhe përgjegjësitë e saj. Detyrat dhe funksioni i këtyre njësive realizohet përmes zbatimit të rregulloreve përkatëse të tyre. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në mënyrë periodike si pjesë e Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ndërmerr edhe anketime semestrale me studentët për të matur cilësinë në mesimdhënie [Ref_079 Raport mbi anketimin studentor cilesia e mesimdhënies.]
Konkluzione	GVJ mendon se UPT ka hartuar udhëzues në lidhje me mesimdhënien, mesimnxënien dhe cilësinë në procesin mësimor. Stafi akademik i angazhuar në programin e studimit është më përvojë dhe eksperiencë. Programi i studimit përfshin studentët në dhënien e mendimit dhe vlerësimit të tyre në lidhje me punën e

	<i>personelit akademik përmes anketimeve periodike që kryen njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kriteret e vlerësimit dhe testimit të njohurive përcaktohen qartë në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies. Kreu IV dhe V japin informacion në lidhje me organizimin e programeve të studimit dhe vlerësimin e dijeve. GVJ konstaton se kjo rregullore përcakton qartë kriteret bazë ndonëse siç kemi theksuar edhe në kriteret më sipër ndihet e nevojshme një rishikim i rregullores së programit të studimit e cila duhet të përcaktojë më qartë disa kritere vlerësimi specifike për këtë program studimi. Rregullorja bazë institucionale është e aksesueshme edhe në website www.upt.al të UPT-së. [Ref_004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies UPT].
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Takimet me stafin akademik dhe studentët theksuan njohjen e përmbajtjes së syllabusit në fillim të lëndës dhe detyrimet përkatëse të tyre. Studentët ishin të mirë-informuar në lidhje me masën e frekuentimit në leksione, seminare dhe procedurën e ankimimit në rast kundërshtimi të vlerësimit të bërë nga ana e pedagogut të lëndës. [Ref. takime në institucion].
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Testimi dhe vlerësimi i njohurive bëhet bazuar në rregulloren kurrikulare të mësimdhënies së UPT-së por edhe në varësi specifike të lëndës. Në këtë drejtim GVJ konstaton Bazuar në rregulloren e UPT-së se format e vlerësimit që ndërmerren në këtë program studimi janë: - Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrje aktive: 10% - Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyra/projekte kursi): 10% - Testimet gjatë vitit: 20% - Provimi pëfundimtar: 60% Mënyra e organizimit të provimit me shkrim është në funksion të natyrës së disiplinës. Në rregulloren e FGJM-së neni 57 përcakton “format e kontrollit të dijeve janë punët

	laboratorike, mbrojtje e detyrave dhe/ose projekteve të kursit, mbrojtje e praktikave në terren dhe e praktikave profesionale, provime të ndërmjetme, provimet e lëndës, provimet e formimit, mbrojtje e diplomave, etj”. [Ref_006 Rregullore e brendshme FGJM_2020.]. Në rregulloren e programit të studimit neni 17 përcakton “Kontrolli i dijeve në çdo lëndë bëhet nëpërmjet vlerësimit të detyrave të kursit, pjesëmarrjes në laboratorë dhe provës përfundimtare, provimit” pa përcaktuar peshën që secila zë në vlerësim [Ref_010 Rregullore PS BSc në Inxhinieri Gjeoinformatike]. GVJ shqyrtoi me vëmendje syllabuset e paraqitura nga institucioni. Në tërësi GVJ i gjen në përputhje me VKM nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. [Ref_023 Syllabuset e lendeve ne PS Bsc Inxhinieri Gjeoinformatike].
Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	GVJ zhvilloi një takim të veçantë me stafin akademik ku këta të fundit shprehën qartë mendimin e tyre në lidhje me ecurinë e studentëve. Staf i akademik ndjek në vazhdimësi progresin e studentëve. Në përfundim të provimit studentët njihen me zgjidhjet korrekte dhe bëjnë vlerësimin në lidhje me produktin e dhënë nga ana e tyre në provim. Në takimin e zhvilluar me studentët u theksua puna e bërë nga stafi akademik në lidhje me ndjekjen e progresit të studentëve. Sidomos në drejtim të aftësisimit praktik të tyre [takim me stafin akademik, takim me studentët].
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve	Nga takimet me studentët dhe personelin akademik të programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Gjeoinformatikë”, GVJ konstatoi se ka një përprjekje të vazhdueshme për angazhimin e studentëve në punë praktike të cilat inkurajojnë sensin e autonomisë dhe synojnë zgjidhjen e problemeve të caktuara [Ref.Takime në institucion]. Ky element konkretizohet nëpërmjet detyrave e projekteve të kursit si dhe punëve laboratorike. Në rastin e detyrave e projekteve të kursit, të cilat në mjaft raste organizohen në grup, nuk mungon edhe ndjekja e vazhdueshme nga ana e pedagogut përkatës dhe asistimi prej tij për tejkalimin e problematikave [Ref.Takime në institucion; Ref_023 Syllabuset e lendeve ne PS Bsc Inxhinieri Gjeoinformatike]

të respektit të ndërsjellë mes tyre.				
Konkluzione	GVJ konstaton se UPT përmes rregullore së zhvillimit kurrikular dhe mësimit dhe rregullore së programit të mësimit ka të përcaktuar kriteret dhe mënyrën e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale. Format e vlerësimit të studentit janë të përcaktuar edhe në syllabuse. Referuar takimeve me stafin akademik si dhe me studentët, rezulton se procedura e informimit realizohet nga stafi akademik konform rregulloreve në fuqi. Studentët njihen me kriteret dhe mënyrat e vlerësimit nëpërmjet sqarimit nga ana e pedagogut të lëndës apo të syllabusit përkatës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Kriteret dhe procedurat për testimin e njohurive të studentit janë përcaktuar në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular të Mësimdhënies në UPT dhe në syllabuset e lëndëve. Ref_023 Syllabuset e lendeve ne PS Bsc Inxhinieri Gjeoinformatike; Ref_004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies UPT]. Testimi i njohurive bëhet gjatë vitit akademik që zhillohet lënda. Provimet zhvillohen në disa sesione: - Sesioni i provimeve në përfundim të semestrit të parë akademik; - Sesioni i provimeve në përfundim të semestrit të dytë të vitit akademik; - Sesioni i provimeve të vjeshtës të cilat zhvillohen kryesisht në Shtator; - Sesione të veçanta të cilat në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi i japin të drejte studentit të përmbushë detyrimet për leëndët e prapambetura; Studenti informohet në fillim të semestrit për përmbajtjen e syllabusit nga pedagogu i lëndës dhe detyrimet përkatëse të tij [takime ne institucion].
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat	Institucioni përdor forma të ndryshme të testimit. GVJ bazuar në evidenact e paraqitura nga institucioni konstaton si vijon më poshtë;

shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	a. Formë testimi më shkrim në formë fizike. Përdorimi i një kodi të personalizuar (ID) shmang formën e abuzimit [Ref_100 Model testimi fizik]. b. Për lëndët e Informatikës përdoret edhe testimi online [Ref_099 Model Testimi Online dhe Celësi i Përgjigjeve] ku siç është theksuar edhe në RVB kryhet në laboratorët e Informatikës në FGJM dhe rrit transparencën në vlerësimin e studentit.
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Testimi dhe vlerësimi përfundimtar bëhet nga një komisioni i përbërë nga dy anëtarë ku njëri prej tyre është edhe titullari i lëndës. Komisionet aprovohen nga Koordinatorin i programit dhe drejtuesi i DGJZGJI në fillim të sezonit të provimit dhe datat e provimeve bëhen publike 2 javë përpara sezonit të provimeve për stafin akademik dhe studentët [Ref_102 Publikimi i datave të Provimeve; Ref_103 Shembull Organizimi Provime Finale]. Tezat e provimit hartohen nga titullari i lëndës. Në syllabus janë përcaktuar qartë sa % zë pjesa teorike dhe përqindja e orëve të ushtrimeve për çdo lëndë në varësi të specifikës përkatëse të tyre [Ref_023 Syllabuset e lendeve në PS Bsc Inxhinieri Gjeoinformatike]. Tezat firmosen nga drejtuesi i DET dhe një kopje e saj depozitohet në arshivën e njësisë bazë [Ref_004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies UPT].
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Vlerësimi i njohurive bëhet me pikë dhe konvertohet në notë përfundimtare. Provimet e pjesshme të zhvilluara gjatë vitit dhe provimi përfundimtar e shoqëron vlerësimin edhe me sqarime aty ku paraqitet e nevojshme. Bazuar edhe në rregulloren e zhvillimit kurrikular të mesimdhënies në UPT, Kreu V pika 9, përcakton se vlerësimi i jepet studentit jo më vonë se 5 ditë nga data e zhvillimit të provimit. Komisioni bën me dije studentin për rezultatin e vlerësimit para plotësimit të dokumentacionit përkatës sipas nenit 36. Studenti ka të drejtën e sqarimit dhe të kundërshtimit të tij duke zbatuar të gjithë procedurat për ankimim jo më vonë se 3 ditë nga data e shpalljes së rezultatit [Ref_004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies UPT; Ref_006 Rregullore e brendshme FGJM_2020; Ref_008 Rregullore e brendshme e DGJZGJ; Ref_010 Rregullore PS BSc në Inxhinieri Gjeoinformatike].
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Stafi akademik është i kujdesshëm në lidhje me çdo formë abuzimi, kopjimi në detyra kursi dhe provime. Penalitetet zbatohet konform rregullores së përcaktuar institucionale të UPT-së. Vëmendje i kushtohet temës së diplomës ku plagjiatura nuk tolerohet. [Ref. takime në institucion].

Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën e studentit dhe jepen në kohë duke qenë se ato diskutohen mes pedagogut dhe studentit. [Ref. 12. Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT, Kreu V]			
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit bazuar në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular të Mësimdhënies në UPT. Komisioni i provimit ka të drejtë ti japë sqarime studentit përpara se të bëjë zbardhjen e notës përfudimtare të tij. [Ref. 12. Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT].			
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Studenti ka të drejtën e kundërshtimit të notës jo më vonë se 3 ditë nga data e shpalljes së notës përfudimtare. Ankesa paraqitet në sekretarinë Dekanit të FGJM-së i cili ka të drejtën të kërkojë për sqarim të gjithë palët e përfshira dhe të marrë vendimin në pranimin e notës ose refuzimin e saj aty ku paraqitet që ankesa është e drejtë nga ana e studentit. Çdo vendim i formës së prerë të marrë nga Dekani i FGJM-së arshivohet në arkivën e fakultetit. [Ref_006 Rregullore e brendshme FGJM_2020]			
Konkluzione	<i>GVJ evidenton se programi i studimit ka të përcaktuar format e testimit dhe vlerësimit të dijeve të studentit. Elementët bazë të procesit mësimor janë mësimdhënia dhe vlerësimi i dijeve. Mësimdhënia realizohet përmes leksioneve, seminareve, ushtrimeve, punëve laboratorike, praktikës profesionale mësimore, detyra/projekte kursi. Elementët bazë të procesit mësimor janë të shprehura qartë në syllabusin e secilës lëndë të programit mësimor. Syllabuset përcaktojnë qartë kriteret e vlerësimit dhe peshën përkatëse. Studentët janë të mirëinformuar në lidhje me të drejtat e tyre për ankimim.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Gjeoinformatikë” mundëson formim të thelluar shkencor për ushtrimin e iniciativave dhe aftësive vendimmarrëse në situata komplekse, për të punuar në fushën e gjeologjisë, të jetë i aftë të përdorë programe në funksion të saj [Ref_011 Plani Mesimor PS BSc në Inxhinieri Gjeoinformatike]. Në përfundim të studimeve studenti ka mundësi të merret me : a. Projektme në fushën e gjeologjisë dhe gjeoinformatikës; b. Zbatime dhe projektme; c. Zbatime dhe mirëmbajtje të rrjetave të transmetimit të të dhënave, të sistemeve kompjuterike etj. Spektri i punësimit është i gjerë. Studentët në përfundim të studimeve të tyre mund të punojnë në institucione shtetërore, në bashki, institucione kadastrale, kompani private. Ata mund të punësohen brenda ose jashtë vendit ku njehsimi i diplomës nuk paraqet vështirësi pasi programi mësimor në përmbajtjen e tij është i ngjashëm me programe të univeristeteve të njohura në Itali dhe në Evropë. <u>Të dhënat statistikore tregojnë që për periudhën 2021-2024 janë diplomuar 72 studentë në këtë program studimi ku vetëm 9 prej tyre janë punësuar në perputhje me fushën e diplomës</u> ndonese në RVB është theksuar që 70% e tyre janë të punësuar [tabela permbledhese, RVB kriteri 1, standarti III.4].
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Programi i studimit përfshin një larmi të gjerë lëndësh/modulesh (sipas kategorive nga A në E) të cilat në përputhje me Udhëzimet e MAS përmbushin kërkesat dhe detyrimet. Në programin mësimor janë vendosur edhe dy grupe lëndë me zgjedhje. Në grupin e dytë janë vendosur lëndët: Integrimi Eropian, Siguria dhe Legjislacioni, Historia e Fizikës dhe teknologjitë moderne dhe Ekonomi dhe Menaxhim [Ref_011 Plani Mesimor PS BSc në Inxhinieri Gjeoinformatike].
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Gjeoinformatikë”, për vetë natyrën e tij, garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e inxhinierisë minerare e ndërthurur me njohuri bazë në fushën e informatikës. Zhvillimi i lëndës gjuhë e huaj me 6 ECTS në kategorinë “D” mundëson që studentët të përvetësojnë njohuri në gjuhën angleze ose italisht dhe të ketë më shumë mundësi dhe mobilitete në programe të huaja ose në leximin e literaturës së huaj të rekomanduar nga ana e stafit akademik [Ref_011 Plani Mesimor PS BSc në Inxhinieri Gjeoinformatike].

Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Kompetencat që studenti përfton janë dhënë në programet lëndore. Në syllabuse janë përcaktuar qartë tematika e orëve të laboratorit dhe frekuentimi i saj në masën 100% të detyrueshëm është një indikator që tregon rëndësinë që institucioni i kushton aftësimit praktik të studentëve [Ref_023 Syllabuset e lendeve ne PS Bsc Inxhinieri Gjeoinformatike]. FGJM zotëron një infrastrukturë të duhur për të mundësuar orët laboratorike. Përmirësimi i saj është në fokus të strategjisë së zhvillimit të DGJZGJI-së [Ref_009_Plani Strategjik DGJZGJI]. GVJ gjatë vizitës së saj në institucion gjeti një infrastrukturë në rikonstrukcion dhe vendosjen e laboratorëve të informatikës dhe të gjeoinformatikës në mjedise të reja. Konkretisht në godinën e vjetër nuk ka pasur laboratorë informatikë por në godinën e re ajo është më sipërfaqje 50.3m2 dhe e pajisur me mjetet e duhur didaktike [tabela përmbledhëse, takim në institucion]. Praktikrat lëndore kryhen në kompani të njohura me të cilat institucioni ka nënshkruar edhe marrëveshje bashkëpunimi. DGJZGJI monitoron procesin e zhvillimit të praktikës mësimore 1 dhe 2 dhe relacionet e përgatitura vlerësohen nga stafi akademik që udhëheq keto praktika.			
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Personeli akademik mbart një përvojë dhe është i njohur në fushën e inxhinierisë minerare dhe informatikës. GVJ konstaton nga të dhënat e mbledhura se mungojnë leksionet e hapura dhe rekomandon fuqimisht përfshirjen e stafit akademik në organizimin e tyre. Ndonëse në RVB është sjellë si shembull zhvillimi i një orë seminaresh nga pedagogët e lëndëve të Informatikës dhe Programimit në web, GVJ nuk gjeti evidenca të tyre. Tabela nr. 20 tregon për mungesë të zhvillimit të leksioneve të hapura dhe GVJ rekomandon si më sipër marrjen në konsideratë nga ana e DGJZGJI zhvillimin e tyre gjatë vitit akademik [table përmbledhese].			
Konkluzione	GVJ konstaton se programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e inxhinierisë minerare e ndërthurur me njohuri bazë në fushën e informatikës. Studenti përmes programit fiton kompetenca themelore dhe e aftëson në fushën e teorisë dhe praktikës. Personeli akademik i angazhuar në program studimi mbartin përvojë në fushën e inxhinierisë minerare dhe informatikës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	Punimi i temës së diplomës është përcaktuar të zhvillohet në programin mësimor në semestrin e dytë të vitit të III-të. Procedura e zhvillimit të procesit të diplomës është dhënë qartë përmes dispozitave në Kreun VIII të rregullores së zhvillimit kurrikular të mësimdhënies në UPT. [Ref_004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies UPT]. Studentët janë të njohur me programin e studimit dhe në përfundim të semestrit të parë të vitit të tretë kanë të drejtën të zgjedhin udhëheqësin e diplomës në bazë të listës së publikuar nga DGJZGJI. [Ref_006 Rregullore e brendshme FGJM_2020, neni 85]. DGJZGJI ndjek një procedurë të qartë në lidhje me organizimin e punës për zhvillimin e temës së diplomës [Ref_055 Procedura konceptimi dhe mbrojtja e diplomës bachelor]. Kanë të drejtën të zhvillojnë temën e diplomës studentët që kanë mesataren mbi 6.5 [Ref_113 Kriteri i notës mesatare për procesin e diplomimit]. Në takimin me stafin akademik u theksua vëmendja e veçantë që i jepet në vlerësim paraqitjes së punimit të studentit në përputhje me kërkesat e dhëna në këtë manual [Ref.takim me stafin akademik].
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Diplomimi bëhet me përgatitjen e temës së diplomës e cila bazuar edhe në Kreun VIII të rregullores së zhvillimit kurrikular të mësimdhënies në UPT është një punim në formën e një projekti ose përmbledhje punimesh të kryera në fushat e programit të studimit Bachelor në "Inxhinieri Gjeoinformatikë". Zgjedhja e temës së diplomës bëhet në diskutim me udhëheqësin e temës së diplomës dhe aprovohet në department. [Ref.12. Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT, neni 54].
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Provimi i formimit përmban grup – lëndë me pesha specifike bazuar edhe në rregulloren e programit të studimit [Ref_010 Rregullore PS BSc në Inxhinieri Gjeoinformatike]. Konkretisht dallojmë: - Informatikë- 20%; - Hartografi dhe GIS – 30% - Gjeologji dhe Gjeofizikë – 30% - Gjeologji e Zbatuar – 20% Komisioni i Posaçëm ngrihet bazuar në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular të Mesimit dhe në Rregulloren e Programit të Studimit

	dhe zhvillon procedurën e provimit dhe vlerësimit brenda afateve kohore të përcaktuara në rregullore [Ref_103 Shembull Organizimi Provime Finale].
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	GVJ në takimet e zhvilluara në institucion konstaton se procedura e përgatitjes së temës së diplomës është konform dispozitave të rregullores së zhvillimit kurrikular të mësimdhënies në UPT dhe Rregullores së FGJM-së. [Ref_004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies UPT; Ref_006 Rregullore e brendshme FGJM_2020]. DGJZGJI përgatit edhe një bankë me tema të diplomave të cilat mund të zgjidhen nga studentët [Ref_104 Shembull krijimi i fondit të temave të diplomave]. Udhëheqësi i temës së diplomës përgatit programin e punës duke përcaktuar edhe afatet e përafërta të realizimit të tij. Udhëheqësi përgatit edhe orët e konsultimeve sipas një grafiku dhe përmes së cilës ai kontrollon edhe ecurinë e punës së panvarur të studentit në drejtim të përgatitjes së temës së diplomës. DGJZGJI organizon dy seanca të veçanta përmes së cilave kontrollon punën e zhvilluar nga studenti në drejtim të punimit të temës së diplomës [Ref_004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies UPT, neni 55].
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	GVJ konstatoi se egzistojnë të gjitha mundësitë për të shfrytëzuar bazën laboratorike të FGJM-së për përgatitjen e temës së diplomës nën drejtimin e udhëheqësit. Gjithashtu, DGJZGJI ofron mundësi tek studentët gjatë përgatitjes së temës së diplomës për të kryer matje apo teste edhe në laboratorë të veçantë që UPT disponon në njësi të tjera bazë apo në kompani private bazuar në marrëveshjet e nënshkruara institucionale [Ref_049 Informacion labororet FGJM; Ref_047 Marrëveshjet me industrinë dhe institucione].
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Organizimi i mbrojtjes së temës së diplomës dhe vlerësimi i saj janë përcaktuar në dispozitat e Kreut VIII, neni 57 të Rregullores së Zhvillimit Kurrikular të Mësimdhënies në UPT. Tema e diplomës mbrohet përpara një komisioni të posaçëm i cili propozohet nga drejtuesi i njësisë bazë dhe miratohet nga Dekani i FGJM-së dhe përbëhet nga 3-5 anëtarë. Mbrojtja e temës së diplomës është publike. Komisioni vlerëson paraqitjen e punimit të temës së diplomës, merr në konsideratë vlerësimin nga recensuesi i diplomës, si edhe përgjigjet që studenti ka dhënë në lidhje me pyetjet e ngritura nga Komisioni i Posaçëm. Vlerësimet e çdo anëtari të komisionit pasqyrohen në procesverbal dhe nota është mesatarizim i vlerësimit që çdo anëtar i komisionit ka dhënë për punimin e paraqitur nga studenti [Ref_004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies UPT, neni 58].
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe	Regjistrimi i formës së diplomës për programin e studimit Bachelor në "Inxhinieri Gjeoinformatikë" në regjistrin shtetëror të diplomave për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor është bërë

suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	përmes Urdhërit të Ministrisë Së Arsimit Sportit dhe Rinisë nr.151 datë 16.04.2021 [Ref_012 Forma e rregjistruar e Diplomes Bsc në Inxhinieri Gjeoinformatike]. Në përfundim të studimeve të ciklit Bachelor në “Inxhinieri Gjeoinformatikë”, studentit i vihet në dispozicion diploma (sipas modelit të miratuar nga MASR) dhe suplementi i diplomës së bashku me listën e notave. [Ref_050 Modeli Suplementit Diplomes BSC Inxhinieri Gjeoinformatike]. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopja e plotë e programit të studimit të zhvilluar. Studenti ka të drejtë të tërheqë një kopje të programit në çdo kohë që ai e sheh të arsyeshme [Ref_04. Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT.			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	FGJM dhe DGJZGJI zbatojnë një sistemi arkivimi të materialeve dhe dokumentacionit në përputhje me ligjin e Arkivave, konform kuadrit ligjor në fuqi dhe rregullores institucionale të UPT-së. Dokumentacioni i studentëve në përfundim të studimeve të tyre ruhet në një kopje në të njëjtën përmbajtje me dosjen që studentit ka pasur gjatë zhvillimit të studimeve. Në rast kërkesë nga ana e studentit pas diplomimit të tij, strukturat bazë japin sqarime dhe vërtetime apo referenca në lidhje me ciklin e studimeve që studentit ka kryer në këtë program studimi [Ref_006 Rregullore e brendshme FGJM_2020; Ref_078 Rregullore për sekretarinë mesimore në FGJM; Ref_030 Modeli i rregjistrave në SM].			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se institucioni ndjek procedurë të qartë në lidhje me provimin final dhe përgatitjen e temës së diplomës. Kanë të drejtën të zhvillojnë të mëdha diplome studentët që kanë mesatare të ponderuar mbi 6.5. GVJ evidenton se programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Gjeoinformatikë” përmban në semestrin e dytë të vitit të tretë mbrojtjen e temës së diplomës. Bazuar në evidencat e paraqitura GVJ konstaton se kjo procedurë zhvillohet nga ana e njësive bazë në përputhje me klauzolat ligjore të shprehur në Rregulloren për Zhvillimin Kurrikular të Mësimin. Staf i akademik mbështet studentit gjatë përgatitjes së tij. Tema e diplomës vlerësohet nga një komision i ngritur me tre anëtarë nga njësia bazë. Në përfundim të tij studentit pajiset me diplomën dhe suplementin saj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
----------	------------------------

Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

Gjatë vizitës në institucion Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) zhvilloi takim me përfaqësuesen e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore. Gjatë këtij takimi në bazë të dokumentacionit që u vu në dispozicion GVJ konstatoi se institucioni disponon dokumentacion të plotë për çdo anëtar të personelit akademik efektiv dhe me kontratë, si dhe personelit ndihmës mësimor dhe administrativ të angazhuar në këtë program studimi, që përfshin: diplomat, ertifikat e ndryshme, vërtetimet për gradat akademike, CV-të, kontratat e punës, librezë shëndetsore, dëshmia e anglishtes, kërkesa e punësimit etj. Kjo gjë u konstatua gjatë shqyrtimit të disa dosjeve të protokolluara, të cilat u përzgjedhën në mënyrë të rastësishme nga GVJ.

Në bazë të Statutit të dhënat e stafit efektiv dhe me atij me kontratë administrohen nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në nivel institucional dhe nga njësia kryesore dhe njësitë bazë për program studimi. I gjithë informacioni administrohet duke respektuar konfidencialitetin e të dhënave personale dhe arkivohen konform akteve rregullatore institucionale

Për tre vite akademike të dhënat e stafit për program studimi vijojnë si më poshtë:

Kualifikimi i stafit akademik të programit të studimit	2021-2022		2022-2023		2023-2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr	14		13		19	
Prof.As.Dr	4		5		6	
Dr	16		21		18	
MSc	5	1		2	3	2
Total	39	1	39	2	36	2

[Ref_001 Statuti i UPT; Ref_004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies UPT; Ref_006 Rregullore e

	brendshme FGJM_2020; Ref_008 Rregullore e brendshme e DGJZGJ; Ref_024 CV e stafit akademik].
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Bazuar ne Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular, DGJZGJI ka në përgjegjesinë e saj edhe pjesën e përpunimit të të dhënave dhe parashikimin e ngarkesës mësimore për stafin efektiv dhe me kontratë që do të angazhohet në këtë program studimi në fillim të secilit vit akademik. Në përfundim të vitit akademik, administrohet edhe evidencat e detajuara për plotësimin e orëve mësimore [Ref_043 Praktika e parashikimit të ngarkesës mësimore në departament]. Bazuar në informacionin e dhënë në dokumentacion, si edhe intervistat e zhvilluara me stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi mund të konkludojmë se stafi i angazhuar në mësimdhënie është plotësisht i kualifikuar nga ana e gradave shkencore (minimalisht anëtarët përmbajnë gradën Doktor). Fusha e kualifikimit është në përputhje të plotë me angazhimin e secilit anëtar me mbulimin e lëndëve dhe specikat e tyre. Sipas përcaktimeve ligjore, personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës, kriteri i cili plotësohet nga stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi. Referuar tabelës përmbledhëse (tabela nr.12.3), GVJ konstaton se personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është personeli akademik kryesisht me kohë të plotë dhe përmbush kërkesat ligjore në fuqi përsa i përket kualifikimit. Sipas të dhënave tabelore të paraqitura nga ana e institucionit stafi akademik me kohë të plotë mbulon 100% të ngarkesës mësimore për këtë program studimi, në përputhje me kriteret e përcaktuara në Ligjin 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" [tabela përmbledhëse].
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Qëndrueshmëria e personelit akademik garantohet përmes kontratës individuale të punës që nënshkruhet me secilin prej tyre. Kontratat hartohen në përputhje me ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe përfshijnë të gjitha elementet e nevojshëm për të siguruar dhe demonstruar vullnetin e universitetit për qëndrueshmërinë e stafit akademik, duke përfshirë kontributet shoqërore dhe shëndetësore siç janë të përcaktuara në legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë. Gjatë vizitës në institucion GVJ pati mundësinë të shihte dosjet fizike të personelit të angazhuar dhe ishin korrekte me dokumentacion të plotë.

Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	FGJM duke u bazuar në Statutin e UPT dhe në rregulloret e brendshme harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik. Njësia bazë harton kriteret e punësimit për personelin akademik dhe ndihmës-akademik ku ofrohet pozicioni vakant dhe miratohen nga Rektori [Ref_001 Statuti i UPT, Neni 42]. Shpalljet për personel shfaqen në faqet web të institucionit dhe të fakultetit. Vlerësimi dhe përzgjedhja e kandidaturave kryhet përmes komisioneve “ad-hoc”, me shumicë anëtarësh nga njësia bazë, në përputhje me përcaktimet e Statutit dhe me procedurat e punësimit në UPT. [Ref. 55. Procedurë për rekrutim stafi akademik PAE dhe PAK]. Punësimi i personelit në institucion përmbyllet me lidhjen e kontratës nëpërmjet Rektorit të UPT si punëdhënës dhe kandidatit fitues si punëmarrës. Ref_052 Procedura e punësimit të personelit PAK në UPT; Ref_051 Procedura e punësimit të personelit PAE në UPT] GVJ nga dokumentacionet e shqyrtuara dhe vizita në institucion konstaton se procedurat për rekrutimin e personelit akademik, janë në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	FGJM/DGJZGJI garantojnë angazhimin e një personeli ndihmës akademik në mbështetje të programit mësimor. Kryesisht personeli ndihmes akademik është i përfshirë në laboratorë, në dhënien e asistencës së personelit akademik gjatë procesit mësimor dhe mbikqyrjen e studentëve gjatë orëve laboratorike [vizitë në institucion].
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit	Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Juridike e UPT është strukturë përgjegjëse për administrimin e të dhënave të personelit akademik dhe ndihmës. Kjo drejtori mbledh, ruan dhe përditëson të dhënat në përputhje me legjislacionin në fuqi [takim me përfaqësues të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në FGJM].

akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	NA
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	NA
Konkluzione	<i>GVJ përveç shqyrtimit të dokumentacionit, gjatë vizitës dhe intervistave konstatoi se institucioni realizon një proces korrekt të</i>

	rekrutimit të personelit akademik, mban një dokumentacion fizik sipas dispozitave liigjore në fuqi për çdo anëtar të personelit akademik të angazhuar ne program. Informacioni profesional për stafin përditesohet çdo fillim viti si në format fizik ashtu edhe elektronikisht, bazuar në gjetje dhe duke evidentuar pjesën përshkimore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Gjeoinformatikë” e zhvillon procesin mësimor në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave (FGJM), i cili disponon pjesë të godinës historike. Raporti i vlerësimit të brendshëm (RVB), si dhe Ref 064 Relacion për infrastrukturën e FGJM, tregon se Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave ka në dispozicion ambiente të mjaftueshme për zhvillimin e procesit mësimor, duke përfshirë sallat e leksioneve (7), sallat e seminareve (14), laboratorët me specifika sipas moduleve lëndore, dhe mjedise të tjera me një sipërfaqe totale të mjaftueshme. Gjatë vizitës në Institucion, GVJ e kishte të pamundur verifikimin e të gjitha ambienteve duke qenë në fazë rikonstruksioni. Aktualisht sallat e mësimdhënies ishin reduktuar në 7 total. Megjithatë, gjatë takimit me stafin akademik të programit dhe takimit me studentët, GVJ nuk konstatoi ndonjë ankesë apo pakënaqësi në lidhje me mjaftueshmërinë dhe përshtatshmërinë për zhvillimin e veprimtarisë mësimore. <i>[Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB), Ref 064 Relacion për infrastrukturën e FGJM, Vizita në Institucion]</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes	Nga vëzhgimi i mjedisëve në FGJM gjatë vizitës, si dhe gjatë takimit me stafin akademik të programit të studimit (PS), GVJ konstatoi që sallat që përdoren gjatë procesit mësimor janë të pajisura me tabela dhe të përshtatshme për përdorim të projektorëve të cilët janë të lëvizshëm dhe thjeshtë të montueshëm nga stafi akademik. Vërehet mungesa e nje kompjuteri fiks në tavolinën e pedagogut, te cilët përdorin laptop dhe projektorë personalë. Në ambjentet mësimore dhe kudo brenda institucionit kishte lidhje të pandërprerë interneti dhe vetëm disa mjedise ishin të pajisura me kondicionim.

përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Raporti i vlerësimit të brendshëm (RVB) dhe Ref 049 Informacion labororet FGJM, thekson se FGJM ka në dispozicion ambiente laboratorike në funksion të PS, disponibiliteti dhe funksionaliteti i të cilave ishte e pamundur të verifikohet për shkak të rikonstruksionit. <i>[Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB), Ref 049 Informacion labororet FGJM, Vizita në Institucion]</i>
Kriteri 3. Labororët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Dosja e Vetëvlerësimit (DVV) përmend se UPT ka 88 labororë specifike sipas moduleve dhe 12 labororë të informatikës (Ref 066 Evidenca mbi labororët në UPT). Nga këto, FGJM zotëron 20 labororë në funksion të programeve të studimit, që zotërojnë pajisje të përditësuara. Bazuar në Ref 049- Informacion labororet FGJM, GVJ evidenton se këto labororë janë në përputhje me objektivat formësuese të programit të studimit dhe përparimit të aktivitetit kërkimor shkencor të studentëve dhe personelit akademik. Për shkak të gjendjes në fazë rikonstruksioni, GVJ nuk arriti dot të vlerësojë nëse këto labororë janë të pajisura mirë dhe nëse pajisjet e tyre janë funksionale. <i>[Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB), Ref 066 Evidenca mbi labororët në UPT, Ref 064 Relacion për infrastrukturën e FGJM, Ref 049 Informacion labororet FGJM, izita në Institucion]</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Bazuar në RVB dhe Ref 066- Evidenca mbi labororët në UPT, UPT zotëron 12 labororë për lëndët e informatikës dhe teknologjisë së informacionit, të cilët janë të pajisur me teknologji të përditësuara për të mbështetur zhvillimin normal të leksioneve dhe seminareve. Në programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Gjeoinformatikë”, lëndët e teknologjisë së informacionit jepen nga personel i ftuar nga Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit (FTI), i cili ka 7 labororë modernë të pajisur me programet profesionale si Java, C#, Python, SQL, Rrjetat, Sistemet Cloud, etj. Njeri nga këta labororë gjendet në godinën e FGJM, dhe disponon 20 poste kompjuteri, si dhe hapësirën e nevojshme për zhvillimin normal të procesit mësimor. <i>[Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB), Ref 066 Evidenca mbi labororët në UPT, Vizita në Institucion]</i>
Konkluzione	<i>Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave (FGJM) ka siguruar mjedise dhe infrastrukturë të përshtatshme për procesin mësimdhënës dhe formimin praktik të studentëve. Sipas Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB) dhe referencave të tjera, FGJM disponon mjedise të mjaftueshme për leksione, seminare dhe labororë specifike, megjithëse gjatë vizitës së GVJ-së verifikimi ishte i pamundur për shkak të rikonstruksionit. Mjediset mësimore janë të pajisura me tabela dhe janë të përshtatshme për përdorim të projektorëve të lëvizshëm dhe thjesht të montueshëm nga stafi</i>

	akademik, megjithatë mungon një kompjuter dhe projektor fiks për pedagogët. Për më tepër, FGJM zotëron laboratorë që përputhen me kërkesat e moduleve dhe objektivat formuese të programit të studimit, ndërsa një laborator i teknologjisë së informacionit është në dispozicion në godinën e FGJM, duke mbështetur normalisht zhvillimin e leksioneve dhe seminareve. Verifikimi i disponibilitetit dhe funksionalitetit të këtyre laboratorëve ishte i pamundur për shkak të rikonstruksionit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	GVJ, bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe në vizitën në institucion, konstatoi që pedagogët e lëndëve prezantojnë çdo fillim semestri tek studentët literaturën bazë dhe ndihmëse që do nevojitet gjatë semestrit, e cila mundësohet nga vetë ato. Tekstet bazë janë në gjuhën shqipe, të autorëve shqiptarë dhe përkthime të autorëve të huaj. Literatura e rekomanduar është në gjuhën shqipe ose angleze dhe shpërndahet si material shtesë me iniciativë të pedagogëve. Përcjellja e literaturës bazë dhe të rekomanduar tek studentët realizohet në format fizik dhe me raste në format elektronik përmes platformës Google Classroom (Ref 62). <i>[Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB), Ref 023 Syllabuset e lendeve ne PS BSc Inxhinieri Gjeoinformatikë, Ref 062 Shembull klase virtuale ne platformen Microsoft Teams, Google Classroom]</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Bazuar në dokumentacionin e përcjellë nga GVB, veçanërisht Ref 023 Syllabuset e lëndëve në PS BSC në “Inxhinieri Gjeoinformatikë”, GVJ konstaton se literatura e lëndëve është specifikuar në programet mësimore dhe se ajo vihet në dispozicion të departamentit çdo fillim viti akademik për përditësime. Tekstet bazë janë në gjuhën shqipe, të autorëve shqiptarë dhe përkthime të autorëve të huaj. Gjatë vizitës në Institucion dhe informacionit të marrë gjatë takimit me stafin akademik te angazhuar ne PS, u konstatua se natyra specifike e degës të kërkon një përditësim të vazhdueshëm dhe dinamik te literaturës, e cila realizohet nga profesorët me anë të materialeve shtesë në anglisht. <i>[Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB), Ref 023 Syllabuset e lendeve ne PS BSc Inxhinieri Gjeoinformatike, Vizita në Institucion]</i>

Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Nga shqyrtimi i DVV, konstatohet që UPT disponon bibliotekën shkencore qendrore, e cila është e lokalizuar në ambientet e Korpusit Qëndror, në sheshin “Nënë Tereza”. Ndërkohë që FGJM ka edhe një bibliotekë specifike e cila ofron një numër të limituar titujsh dhe afro 45 poste leximi/konsultimi, aktualisht në fazë rikonstruksioni. Gjatë vizitës në institucion, GVJ e pati të pamundur të vlerësojë nëse biblioteka e FGJM-së është e pajisur me burime të mjaftueshme dhe nëse janë të aksesueshme për të gjithë studentët dhe stafin akademik, për shkak të rikonstruksionit. <i>[Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB), Ref 074 Informacion mbi Bibliotekat në UPT, Vizita në Institucion]</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Fondi fizik i bibliotekës qendrore është i gjerë dhe i pasur me literaturë vendase dhe të huaj: libra, monografi, revista, botime konferencash, etj. Megjithatë, biblioteka e ndodhur pranë Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave ka një fond të limituar fizik, duke shtruar nevojën për përmirësime dhe shtesa. GVJ rekomandon pasurimin dhe përditësimin e fondit fizik të bibliotekës së ndodhur pranë FGJM, me literaturë mësimore bazë, të rekomanduar dhe plotësuese, në përputhje me nevojat e studentëve dhe stafit akademik. <i>[Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB), Ref 068 Informacion mbi Bibliotekat në UPT]</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Nga shqyrtimi i RVB, konstatohet se në bibliotekat e UPT-së është i integruar sistemi COBISS (Co-operative Online Bibliographic System and Services), duke ofruar qasje online dhe mundësi për shfrytëzim të burimeve bibliotekare nga të gjithë studentët dhe stafi akademik. Sistemi ofron akses në katalogët online, revista shkencore, libra elektronikë dhe burime të tjera të nevojshme për studimet akademike. GVJ konstatoi nga takimi me stafin dhe studentët e programit të studimit se sistemi i bibliotekave online (COBISS) nuk gjen përdorim të gjerë. Për të rritur përdorimin e sistemit COBISS, rekomandohet organizimi i trajnimeve dhe fushatave ndërgjegjësuere për stafin dhe studentët, si dhe integrimi i udhëzimeve për përdorimin e tij në kurikulat përkatëse. Kjo do të sigurojë shfrytëzimin e plotë të burimeve bibliotekare që sistemi ofron.

	<i>[Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB), Ref 069 Biblioteka digjitale]</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka qendrore e Universitetit Politeknik të Tiranës është e pajisur me lidhje interneti për të lehtësuar aksesin e studentëve në burimet e saj elektronike. Këto përfshijnë sistemin COBISS, i cili ofron mundësi për kërkime online dhe akses në katalogët e bibliotekës. Në bibliotekë mungojnë postet e pajisura me kompjutera për të ndihmuar studentët në përdorimin e këtyre burimeve. Për të përmirësuar aksesin e studentëve në burimet elektronike të bibliotekës, rekomandohet instalimi i posteve të pajisura me kompjutera brenda bibliotekës qendrore të Universitetit Politeknik të Tiranës. Kjo do të lehtësojë përdorimin e sistemit COBISS dhe të burimeve të tjera online, duke ofruar një mjedis të përshtatshëm për kërkim dhe studim akademik. <i>[Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB), Ref 068 Informacion mbi Bibliotekën në UPT, Ref 069 Biblioteka dixhitale]</i>
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	GVJ konstatoi se Biblioteka e UPT-së operon sipas një rregulloreje dhe ofron shërbim studentëve çdo ditë të javës, duke përfshirë edhe ditën e shtunë, për të siguruar që shërbimi të jetë në dispozicion jo vetëm gjatë orareve të tyre të studimit, por edhe në mënyrë të pandërprerë. Megjithatë, biblioteka e FGJM është aktualisht jashtë funksionit për shkak të rikonstruksionit.
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit,	Bazuar në RVB, dokumentacionin e ofruar, dhe në vizitën në institucion, GVJ konstaton që departamenti, në periudhë të vazhdueshme, evidenton nevojat e fondit fizik të bibliotekës dhe ja kalon fakultetit. Ky i fundit ndjek procesin e përditësimit të këtij fondi. <i>[Ref 067 Pasurimi i koleksionit të Bibliotekës Shkencore 2021-2024, Ref 093 Praktike mbi hartimin e Buxhetit në nivel njesie kryesore-baze, Vizita në Institucion]</i>

duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.									
Konkluzione	<i>Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Gjeoinformatikë” në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave (FGJM) përmban literaturë të nevojshme për mësimdhënie dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies. Megjithatë, gjatë vizitës u konstatua se biblioteka specifike e FGJM është aktualisht jashtë funksionit për shkak të rikonstruksionit. Ndërkohë, literatura bazë dhe ndihmëse vihet në dispozicion nga pedagogët në formë fizike ose digjitale, dhe publikohet në silabuset perkatëse. Institucioni duhet të përmirësojë qasjen në burimet elektronike, si sistemi COBISS, dhe të instalojë poste kompjuterike në bibliotekë për të ndihmuar studentët në përdorimin e këtyre burimeve. Gjithashtu, rekomandohet pasurimi dhe përditësimi i fondit fizik të bibliotekës për të përmbushur nevojat e studentëve dhe stafit akademik.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktiviteteve akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	GVJ konstatoi nga DVV dhe vizita në institucion që Sekretaria Mësimore (SM) realizon menaxhimin e informacionit që lidhet me studentët. Gjatë takimit në sekretarinë e programit u bë e mundur shqyrtimi i regjistrave të studentëve dhe dosjeve të zgjedhura të studentëve në programin Bachelor në "Inxhinieri Gjeoinformatikë", të cilat rezultuan me informacion të plotë të nevojshëm sipas kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi. Sistemi tjetër i menaxhimit të informacion në përdorim është platforma <i>BIT ALBANIA</i> si një sistem i informatizuar për të administruar të dhënat për të gjithë studentët që nga hyrja në universitet e deri në diplomimin e tyre.

	<i>[Ref 030 Modeli rregjistrave ne SM, Vizita në Institucion]</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	GVJ konstatoi se informacioni mbi stafin akademik, ndihmës akademik dhe partnerët e angazhuar në PS menaxhohet dhe arkivohet nga struktura e Burimeve Njerëzore. Sekretaria e dekanit të FGJM-së mbledh dhe perditëson informacionin akademik dhe shkencorë të stafit dhe e arkivon. Gjatë vizitës u shqyrtuan dy dosje fizike të stafit, të cilat rezultuan me informacion të perditësuar. <i>[Vizita në Institucion]</i> Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave administron informacionin përmes platformës BIT-ALBANIA, e cila përdoret për një gamë detyrash administrative, nga regjistrimi i studentëve deri tek mbajtja e performancës akademike. Kapacitetet e sistemit demonstrohen përmes video tutorialeve të përgatitura dhe respektimit të ligjeve për mbrojtjen e të dhënave.
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Studentët kanë qasje të dedikuar në <i>BIT- ALBANIA</i> , nga ku aksesojnë informacionin e nevojshëm akademik, që përbëhet kryesisht nga informacioni mbi notat, regjistrimi për provim dhe plotësimi i pyetësorëve/anketave të ndryshme. Stafi akademik nuk ka qasje të dedikuar në sistem. Për të përmirësuar menaxhimin dhe qasjen në informacionin akademik në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave (FGJM), rekomandohet zgjerimi i funksioneve interaktive të platformës BIT-ALBANIA për stafin akademik, duke përfshirë hedhjen e mungesave dhe notat e vlerësimit progresiv. Kjo do të rrisë efikasitetin dhe saktësinë e të dhënave. <i>[Vizita në Institucion, Ref 039 Manual përdorimi platforma Sekretarisë Mësimore BitAlbania]</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Në takimet me stafin akademik dhe studentët, si dhe pas shqyrtimit të DVV, GVJ konstatoi se platforma BIT- ALBANIA është një sistem modular pasiv. Për momentin ai nuk ofron forma të komunikimit aktiv apo të shkëmbimit të informacionit ndërmjet stafit dhe studentëve. GVJ konstatoi nga vizita në institucion që stafi përdor platformën Google Classroom si metodë interaktive për komunikim të vazhdueshëm me studentët dhe shpërndarjen e materialeve ndihmëse dhe programit të lëndës. <i>[Vizita në Institucion, Ref 039 Manual përdorimi platforma Sekretarisë Mësimore BitAlbania]</i>
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale	Sistemi BIT-ALBANIA mundëson verbalizimin dhe zyrtarizimin e procedurës së plotësimit të detyrimeve të studentëve nga SM,



të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	kontrollin e historisë së studentit dhe nxjerrjen e të dhënave sipas kërkesës së tij. GVJ gjykon se, në tërësi, sistemi i menaxhimit BIT-ALBANIA ka nevojë për përmirësime për të garantuar monitorimin e aktivitetit akademik dhe administrativ të institucionit në kohë reale. Rekomandohet zgjerimi i funksioneve të platformës për të përfshirë hedhjen e mungesave dhe notat e vlerësimit progresiv, si dhe ofrimi i trajnimeve dhe mbështetjes së vazhdueshme për stafin dhe studentët, për të rritur efikasitetin dhe saktësinë e të dhënave. <i>[Vizita në Institucion, Ref 039 Manual përdorimi platforma Sekretarisë Mësimore BitAlbania]</i>			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	GVJ konstatoi se në faqen zyrtare të internetit të FGJM, UPT Tiranë, publikohet në gjuhën shqipe i gjithë informacioni i nevojshëm mbi programet e studimit të ofruara, personelin akademik, aktivitetet e realizuara, si dhe shërbimet e njoftime të tjera për të gjithë të interesuarit. Gjithashtu rrjetet sociale të Departamentit paraqesin informacion të vazhdueshëm për të interesuarit. Faqja zyrtare web e UPT-së jep informacion edhe në gjuhë të huaj, anglisht. <i>[Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB), https://fgjm.edu.al/, https://upt.al/]</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni i arsimit të lartë UPT, Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave (FGJM), disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional që mbështet administrimin, informimin dhe monitorimin e aktivitetit akademik, financiar dhe administrativ për programin e studimit. Platforma BIT-ALBANIA përdoret për administrimin e të dhënave të studentëve dhe personelit akademik, megjithëse aktualisht nuk ofron funksionalitete interaktive për komunikimin dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet stafit dhe studentëve.</i> <i>Rekomandohet zgjerimi i funksioneve të platformës për të përfshirë hedhjen e mungesave dhe notat e vlerësimit progresiv, si dhe përmirësimi i aftësive të monitorimit në kohë reale për aktivitetet akademike dhe administrative. Gjithashtu, duhet të sigurohet që informacioni mbi programet e studimit dhe aktivitetet të publikohen në faqen zyrtare të fakultetit në të paktën dy gjuhë, duke përfshirë gjuhën shqipe.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë 80/2015, UPT miraton tarifat e shkollimit për çdo cikël studimi dhe harton raporte financiare që paraqiten për miratim si pjesë e raportit vjetor të Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit. Këto raporte përfshijnë analizën e kostove financiare për studentët dhe buxhetet për çdo vit pasardhës, duke siguruar planifikimin e duhur financiar për mbarëvajtjen e programeve të studimit. <i>[Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, Ref 001 Statuti i UPT (Neni 21), Ref 108 Analizë financiare për nxjerrjen e kostos së programeve të studimeve Bachelor FGJM]</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Plani i financimit të njësisë bazë, DGJZGJ, përfshin financimin e burimeve njerëzore, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjeteve dhe teknologjive mbështetëse, si dhe shpenzimet për literaturën dhe aksesin në bibliotekë. Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave ka hartuar dhe aprovuar Planin Strategjik për periudhën 2020-2024, i cili përmban detaje të hollësishme mbi financimin e këtyre shpenzimeve. <i>[Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, Ref 093 Praktike mbi hartimin e Buxhetit në nivel njesie kryesore-baze, Ref 007 Plani strategjik FGJM]</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik,	Organigrama e UPT-së ka përcaktuar qartë përgjegjësinë për auditimin e brendshëm dhe të jashtëm, duke përfshirë Kartën e

vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Auditit të Brendshëm dhe pozicionin e Bordit të Administrimit. UPT kryen auditime të rregullta për të vlerësuar efektivitetin financiar dhe për të siguruar transparencë në menaxhimin e burimeve financiare. Të dhënat mbi veprimtarinë financiare bëhen publike në faqen zyrtare të UPT: https://upt.edu.al/legjislacioni/programi-i-transparences/. <i>[Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB), Ref 005 Organigrama e UPT]</i>
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	UPT, përmes Drejtorisë Ekonomike, strukturës për menaxhimin financiar dhe zbatimin e politikave financiare, dokumenton dhe raporton gjendjen financiare për çdo program studimi. Ky raportim përfshin analizën financiare për çdo vit akademik (Ref 87), duke siguruar një pasqyrë të qartë të shpenzimeve dhe të ardhurave të programit. <i>[Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, https://upt.edu.al/drejtimi-akademik-administrativ/drejtore/drejtoria-ekonomike/, Ref 087 Projekt-Buxheti Afatmesem 2024-2026]</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	UPT siguron që fondet e nevojshme për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e burimeve akademike dhe teknologjike të jenë të disponueshme. Ky institucion angazhohet në mënyrë aktive në sigurimin e granteve dhe financimeve të tjera për të mbështetur zhvillimin e programeve të studimit dhe për të përmirësuar cilësinë e burimeve të ofruara. <i>[Ref 088 Tabela e të ardhurave dhe investimeve 2021-2024, Ref 089 Lista e shërbimeve të ofruara për të tretë FGJM]</i>
Konkluzione	<i>UPT garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për procesin mësimor-kërkimor dhe mbarëvajtjen e programeve të studimit. Institucioni harton raporte financiare dhe plane mbështetëse në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë 80/2015, duke siguruar shpenzimet për burimet njerëzore, mirëmbajtjen e mjeteve, dhe literaturën. UPT kryen auditime të rregullta për të vlerësuar efektivitetin financiar dhe raporton gjendjen financiare për çdo program studimi. Për të garantuar qëndrueshmërinë financiare, UPT siguron fondet e nevojshme dhe</i>

	<i>angazhohet në sigurimin e granteve dhe financimeve të tjera për mbështetjen e programeve</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në Statutin dhe Rregulloret e UPT-së, si dhe informacionin e faqes zyrtare të internetit të institucionit, GVJ konkludon se Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje. Dokumentet referuese përfshijnë Statutin e UPT-së, Rregulloren e Zhvillimit Kurikular dhe Mësimdhënies, dhe Planin Strategjik të FGJM 2018-2023. Po ashtu, janë hartuar dhe zbatohen rregullore të ndryshme për menaxhimin e procesit mësimor dhe të njohjes së diplomave. <i>[Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, Ref_001 Statuti i UPT, Ref_002 Plani Strategjik 2019-2024 i UPT, Ref_003 Kodi i Etikës i UPT, Ref_004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies në UPT]</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	GVJ konstatoi se Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT) ndjek politika dhe kriteret të qarta për pranimin e studentëve, të cilat bazohen në legjislacionin në fuqi dhe rregulloret e brendshme të universitetit (Ref 004 Rregullore për Zhvillimin Kurikular dhe Mësimdhënies në UPT). Kriteret e pranimit janë të përshkruara në detaje dhe të zbatueshme për çdo kandidat që aplikon në një program studimi (Neni 19, Neni 20). Vendosja e kriterëve mbështetet në parimet e transparencës dhe barazisë për të gjithë kandidatët (Ref 027 Praktika e Miratimit të Kriterëve për Pranimin e FGJM).

	Gjithashtu, sistemi i menaxhimit të informacionit për studentët dhe procesin e regjistrimit është i mirëorganizuar, duke siguruar që të gjitha procedurat të jenë të qarta dhe të aksesueshme për studentët dhe stafin. Pranimi i kandidatëve bazohet në rezultatet e Maturës Shtetërore dhe procesi është i monitoruar nga autoritetet përkatëse për të siguruar një garë të drejtë dhe të barabartë për të gjithë aplikantët). <i>[Ref 004 Rregullore për Zhvillimin Kurikular dhe Mësimdhënies në UPT, Ref 027 Praktika e Miratimit të Kriteve për Pranimin e FGJM]</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	GVJ konstatoi se Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT) ndjek politika dhe kriteret të qarta për pranimin e studentëve, të cilat bazohen në legjislacionin në fuqi dhe rregulloret e brendshme të universitetit (Ref 004 Rregullore për Zhvillimin Kurikular dhe Mësimdhënies në UPT- Neni 19, Neni 20), (Ref 027 Praktika e Miratimit të Kriteve për Pranimin e FGJM). Kriteret e pranimin janë të përshkruara në detaje dhe të zbatueshme për çdo kandidat që aplikon në një program studimi. Vendosja e kriteve mbështetet në parimet e transparencës dhe barazisë për të gjithë kandidatët (Ref 025 Guida Studentore). Gjatë vizitës në institucion, u vërtetua se procesi i pranimin është i mirëorganizuar dhe transparent. Regjistrimi i studentëve në programet e ciklit të parë të studimeve Bachelor në "Inxhinieri Gjeoinformatikë" kryhet nga SM të FGJM-së, duke zbatuar renditjen sipas listave të publikuara të studentëve fitues. Institucioni bashkëpunon me struktura të ngritura në zbatim të maturës shtetërore. <i>[Ref 004 Rregullore për Zhvillimin Kurikular dhe Mësimdhënies në UPT (Neni 19, Neni 20), Ref 027 Praktika e Miratimit të Kriteve për Pranimin e FGJM, Ref 025 Guida Studentore]</i>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimin dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të	Bazuar në dokumentacionin e DVV dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se procedurat dhe kriteret e përdorura në përzgjedhjen e studentëve, në vlerësimin përgjatë ciklit të studimeve e më pas, deri në diplomim, janë lehtësisht të kuptueshme dhe të disponueshme për të gjithë të interesuarit. Këto kriteret dhe procedura janë të aksesueshme dhe në faqen zyrtare të universitetit. Pranimi i kandidatëve bazohet në rezultatet e Maturës Shtetërore dhe procesi është i monitoruar nga autoritetet përkatëse për të siguruar një garë të drejtë dhe të barabartë për të gjithë aplikantët (Ref 025 Guida Studentore), (Ref 027 Praktika e Miratimit të Kriteve për Pranimin e FGJM). Cdo fillim viti akademik, pranë

aksesueshme nga publiku.	FGJM-së, ngrihet një grup <i>ad-hoc</i> për njohjen dhe ekuivalentimin e krediteve, si dhe shqyrtimin e transferimeve. Për më tepër, universiteti përdor udhëzues studentorë dhe platforma digjitale të cilat i ofrojnë studentëve informacion të detajuar për çdo hap të procesit akademik. Kjo lehtëson orientimin dhe përparimin e tyre gjatë studimeve, duke garantuar qasje të thjeshtuar në çdo aspekt të rëndësishëm të karrierës së tyre akademike (Ref 031 Aktivitete Informuese mbi Programet e Studimit), (Ref 032 Aktivitete të Organizuar nga Zyra e Karrierës). <i>[Ref 004 Rregullore për Zhvillimin Kurikular dhe Mësimdhënies në UPT, Ref 025 Guida Studentore, Ref 027 Praktika e miratimit te kriterëve te pranimit ne FGJM, Ref 031 Aktivitete Informuese mbi Programet e Studimit, Ref 032 Aktivitete të Organizuar nga Zyra e Karrierës, Ref 041 Praktike transferim studimesh FGJM]</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	GVJ konkludon se, përpara fillimit të çdo viti akademik, Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT) informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat dhe kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të programit të studimit. Ky informacion publikohet në faqen zyrtare të internetit të UPT-së dhe përfshin guida studentore, lista të renditura të kandidatëve, si dhe broshura informuese. Gjithashtu, UPT organizon aktivitete informuese dhe takime promovuese për të siguruar që të gjithë të interesuarit të jenë të informuar në lidhje me kriteret e pranimit dhe procedurat përkatëse. <i>[Ref 025 Guida Studentore, Ref 031 Aktivitete Informuese mbi Programet e Studimit, Ref 032 Aktivitete të Organizuar nga Zyra e Karrierës, Ref 094 Fletë-palosje Informuese]</i>
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	GVJ konstatoi se UPT ka hartuar kuotat e pranimit për kategori të veçanta si për kandidatët për studentë nga trojet, pakicat kombëtare etj. Programi Bachelor në “Inxhinieri Gjeoinformatikë” nuk përjashton mundësinë e integritit të shtresave më vulnerabël të shoqërisë. Ky informacion është i aksesueshëm për publikun dhe të interesuarit në faqen e internetit, duke garantuar një proces të drejtë dhe të barabartë për të gjithë aplikantët. <i>[Ref 026 Praktika e miratimit te kuotave te pranimit ne FGJM]</i>
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e	Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT) harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. Ky informacion është i aksesueshëm për publikun dhe të interesuarit përmes platformave zyrtare të komunikimit të UPT-së, duke siguruar një proces të drejtë dhe transparent për kandidatët ndërkombëtarë.

kandidatëve nga shtete të tjera.	[Ref_026 Praktika e miratimit të kuotave të pranimit në FGJM, Ref_027 Praktika e miratimit të kriterëve të pranimit në FGJM]			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT) harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. UPT ka krijuar politika për dhënie e bursave, gjysmëbursave dhe tarifave të reduktuara, për studentët me nota mesatare të larta dhe për ata me familje me probleme sociale dhe në nevojë. Për këtë, UPT u ofron mundësi studentëve të aplikojnë për bursa bazuar në VKM nr. 397, datë 29.06.2023, dhe në VKM 39, datë 23.01.2019. Gjithashtu, për programet e studimit të shpalluara prioritet kombëtar, Institucioni ofron një bursë shtesë për studentët përgjatë periudhës 3 vjecare të ciklit të studimit. UPT ka nënshkruar marrëveshje me institucione dhe kompani për të siguruar punësimin e studentëve pas përfundimit të studimeve, duke i ndihmuar ata të zhvillojnë karrierën e tyre profesionale në Shqipëri. [Ref 031 Aktivitete Informuese mbi Programet e Studimit, Ref 032 Aktivitete të Organizuar nga Zyra e Karrierës, Ref 094 Fletë-palosje Informuese, VKM 397, date 29.06.2023]			
Konkluzione	Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT) ka hartuar dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja deri në diplomim. Këto politika dhe procedura janë të bazuara në legjislacionin në fuqi dhe rregulloret e brendshme të universitetit, duke siguruar barazi dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët dhe studentët. Institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të programit të studimit përpara fillimit të çdo viti akademik, duke përfshirë kriteret për kandidatët me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara, si dhe për kandidatët ndërkombëtarë. UPT gjithashtu harton politika të ndihmës dhe bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për zhvillimin ekonomik të vendit. Këto masa dhe përpjekje garantojnë një proces të drejtë, transparent dhe mbështetës për të gjithë studentët, duke kontribuar në zhvillimin dhe përparimin e tyre akademik dhe profesional.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit shoqërues (Ref 004, Ref 006, Ref 025, Ref 096), informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion dhe të paraqitur në faqen zyrtare internet të UPT-së, GVJ vlerëson se në dispozicion të studentëve vihet informacion i plotë lidhur me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të tyre si dhe lidhur me procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme në rast transferimi studimesh. Rregulloret e Fakultetit dhe programit ofrojnë informacion mbi të gjithë procesin. <i>[Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB), Ref 004 Rregullore për Zhvillimin Kurikular dhe Mësimdhënies në UPT, Ref_006 Rregullore e brendshme FGJM, Ref_025 Guida studentore, Ref_096 Informacion specialisti karrierre, Vizita në Institucion]</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Institucioni ka siguruar që procedurat dhe kriteret e njohjes së kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme të jenë të qarta dhe të komunikohen në mënyrë efektive. GVJ konstaton që ky informacion është i disponueshëm në dokumente të politikave akademike (Ref 004) dhe udhëzues të veçantë që detajojnë hapat që duhet të ndjekin studentët, si dhe publike në faqen e internetit https://upt.al/index.php?option=com_content&view=article&id=332&Itemid=296&lang=sq UPT njeh studime të pjesëshme të realizuara jashtë institucionit. Në kuadër të projekteve të ndryshme europiane, studentët mund të shkojnë dhe të realizojnë lëndë/module jashtë vendit, me të cilat UPT ka marrëveshje të shkëmbimit. <i>[Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB), Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies në UPT]</i>
Kriteri 3. Institucioni informon	Institucioni ka përcaktuar dhe publikuar qartë kriteret dhe procedurat për vlerësimin e dijeve dhe aftësive të studentëve. Ky informacion përfshihet në

studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	kurrikulën e programit të studimit dhe është i aksesueshëm për studentët përmes udhëzuesve dhe manualeve specifike. Gjithashtu, gjatë javës së parë të semestrit, pedagogët i njohin studentët me përmbajtjen e syllabusit të lëndës, në të cilin përfshihen edhe format e vlerësimit konkret për secilën lëndë. <i>[Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies në UPT, Ref 038 Procedura për vlerësimin e dijeve në FGJM, https://upt.al/index.php?option=com_content&view=article&id=332&Itemid=296&lang=sq]</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	GVJ konstaton që institucioni ka ndërmarrë hapa të qartë për të siguruar që studentët janë të mirëinformuar mbi procedurat dhe kriteret që lidhen me përgatitjen e punimit të diplomës dhe procesin e diplomimit. Këto informacione ofrohen përmes rregulloreve të dedikuara, si “Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT”, si dhe përmes dokumenteve të tjera specifike që trajtojnë konceptimin dhe mbrojtjen e diplomave, si “Procedura konceptimi dhe mbrojtja e diploms bachelor”. Për më tepër, nga vizita në institucion konstatohet që zyra e karrierës dhe departamentet akademike angazhohen aktivisht në informimin e studentëve përmes takimeve dhe udhëzimeve të posaçme, duke u siguruar që këta të fundit të jenë plotësisht të ndërgjegjshëm për hapat që duhet të ndjekin. <i>[Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies në UPT, Ref 055 Procedura konceptimi dhe mbrojtja e diplomes bachelor, Ref 078 Rregullore Sekretarise Mesimore FGJM]</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon	Në mënyrë periodike, çdo fillim viti akademik, UPT publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. Për shembull, “Guida e Studentëve” dhe “Njoftimi për Ceremoninë e Vitit të Ri Akademik”. Këto takime dhe udhëzues ndihmojnë në qartësimin e çdo aspekti të programit të studimit, duke siguruar që studentët të jenë të përgatitur dhe të informuar për çdo hap të ciklit të tyre akademik. Këto përpjekje janë mbështetur edhe nga Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit, e cila si njësi strukturore mbështetëse e UPT-së, luan një rol kyç në komunikimin e informacionit dhe mbështetjen e studentëve për të marrë vendime të informuara. <i>[Ref 025 Guida studentore, Ref 028 Njoftim per ceremonine e vitit te ri akademik, Ref 031 Aktivitete informuese mbi programet e studimit]</i>

takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.				
Konkluzione	<i>Bazuar në analizën e dokumenteve dhe procedurave të UPT-së, GVJ konstaton se institucioni ka përmbushur në mënyrë të plotë standardin për kriteret e përmendura më lart. Politikat janë të qarta, të dokumentuara dhe të zbatueshme, duke garantuar transparencë dhe qartësi në çdo hap të procesit akademik të studentëve. Kjo siguron që studentët të kenë qasje të barabartë në informacion dhe mbështetje të vazhdueshme gjatë gjithë ciklit të tyre akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	GVJ konstaton se informacioni për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit është bërë i qartë përmes rregulloreve si "Rregullorja e PS BSc në "Inxhinieri Gjeoinformatikë" dhe njoftimeve të vazhdueshme në faqet zyrtare të institucionit dhe fakultetit. Për më tepër, organizimi i takimeve informuese për studentët në fillim të vitit akademik dhe përfshirja e pedagogëve kujdestarë janë praktika të mira që lehtësojnë procesin e komunikimit dhe informimit të studentëve. <i>[Ref 010 Rregullore PS BSc në Inxhinieri Gjeoinformatikë, Ref 028 Njoftim për ceremoninë e vitit të ri akademik, Ref 033 Lista e pedagogëve kujdestarë, Ref 096 Informacion nga specialisti i karrierës, Ref 035 Uebfaqe FGJM Facebook, Ref 036 Uebfaqe FGJM në Instagram, Ref 025 Guida studentore]</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të	UPT, FGJM dhe DGJZGJ ndjekin një politikë të informimit të vazhdueshëm të studentëve nëpërmjet formave të ndryshme, si

studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	njoftimet në faqen zyrtare të internetit, njoftimet në ambientet e fakultetit, komunikimin direkt me pedagogët, tutorët, përgjegjësin e departamentit. Gjithashtu, në orët e para të semestrit, pedagogu ve në dispozicion të studentëve informacion e posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese nëpërmjet syllabusit. Këto dokumente janë të aksesueshme dhe përmbajnë detaje të hollësishme për çdo modul dhe lëndë të përfshirë në programin e studimit. <i>[Ref 008 Rregullore e brendshme e DGJZGJ, Ref 023 Syllabuset e lendeve ne PS Bsc Inxhinieri Gjeoinformatike]</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Përmes nënshkrimit të marrëveshjeve me industri të ndryshme, universitete të tjera, dhe institucione vendore e të huaja, institucioni ka krijuar një rrjet partnerësh që ndihmojnë studentët në zhvillimin e aftësive praktike dhe orientimin drejt tregut të punës. UPT, nga viti 2016 ne vazhdim, ka realizuar 13 marrëveshje me universitete vendase, 57 marrëveshje me universitete të huaja, 55 marrëveshje me kompani që operojnë në tregun tonë, dhe 15 marrëveshje me institucione shtetërore (Ref 045, Ref 047). Gjithashtu, Zyra e Këshillimit të Karrierës organizon aktivitete dhe ofron shërbime për t'i ndihmuar studentët në përgatitjen për karrierë dhe lidhjen me tregun e punës. <i>[Ref 032 Aktivitete të organizuara nga Zyra e Karrierës, Ref 045 Marrëveshjet Institucionale UPT, Ref 047 Marrëveshjet me industrinë dhe institucione]</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	GVJ konstaton që institucioni ka siguruar që studentët të kenë qasje të plotë dhe të përditësuar në informacionet që lidhen me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën dhe infrastrukturën e nevojshme. Përmes platformave të ndryshme online, si faqet e dedikuara të fakultetit dhe sistemet e menaxhimit të të dhënave Bit - ALBANIA, studentët informohen për orarin e mësimave, sesionet e provimeve dhe procedurat e mbrojtjes së diplomave. Takimet me pedagogët kujdestarë dhe komunikimi i vazhdueshëm përmes postës elektronike janë mjete kryesore të përdorura për të garantuar që studentët të jenë të informuar dhe të angazhuar gjatë procesit akademik. <i>[Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB), Ref 033 Lista e pedagogëve kujdestarë, Ref 062 Shembull klase virtuale ne platformen Microsoft TeamsGoogle Classroom]</i>
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet	Informacioni në lidhje me programin e studimit BSc në "Inxhinieri Gjeoinformatikë", orari, struktura mësimore, etj, është i aksesueshëm nga studenti edhe online nëpërmjet platformës Bit-

përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	ALBANIA e cila ofrohet me mbështetjen e Rrjetit Akademik Shqiptar. (https://www.bit-albania.com/upt6.php) Syllabuset u vihen në dispozicion studentëve në fillim të semestrit. Në kuadër të situatës së krijuar nga pandemia globale COVID-19, në FGJM u aplikua mësimi në distancë nëpërmjet platformës Google Classroom dhe Microsoft Teams. <i>[Ref 031 Aktivitete informuese mbi programet e studimit, Ref 062 Shembull klase virtuale ne platformaten Microsoft TeamsGoogle Classroom]</i>			
Konkluzione	<i>Bazuar në analizën e dokumenteve dhe procedurave të UPT-së, GVJ konkludon se institucioni ka përmbushur në mënyrë të plotë standardin për kriteret e përmendura më lart. Institucioni ofron informacion të qartë, të dokumentuar dhe të aksesueshëm për studentët lidhur me strukturën, përmbajtjen, mundësitë e punësimit dhe çdo aspekt tjetër të rëndësishëm të programit të studimit. Kjo garanton që studentët të jenë të informuar dhe të mbështetur gjatë gjithë ciklit të tyre akademik, duke rritur kështu mundësitë e tyre për sukses akademik dhe profesional.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.

Nga vizita në sekretarinë mësimore (SM) verifikuam që mbahej regjistri i të diplomuarve në vite sipas programeve të studimit. Gjithashtu, SM mban në formë të shkruar Rregjistrin Themeltar të Studentëve, Rregjistrin e Arritjeve Akademike, Rregjistrin e Lëshimit të Diplomave.

Ruajtja dhe përpunimi i këtyre të dhënave bëhet në respektim të parimit të konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale.

[Ref 030 Modeli rregjistrave ne SM, Vizita në Institucion]

Sipa viteve akademikë	Të regjistruar për herë të parë	Nota mesatare në hyrje	Të ç'regjistruar	Total
2019-2020	50		7	43
2020-2021	48		10	38
2021-2022	50	7.89	4	46
2022-2023	37	7.67	1	36
2023-2024	22	8	-	22
Total	207	7.85	22	185

Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.

Programi i studimit BSc "Inxhinieri Gjeoinformatikë" menaxhohet nga sekretaria mësimore e FGJM-së. Institucioni mirëmban regjistrin themeltar, ku janë të regjistruar studentët ndër vite, si studente të regjistruar për herë të parë, ashtu edhe ata të transferuar nga universitete të tjera.

Në rregjister hidhen të gjitha të dhënat në lidhje me progresin akademik të studentit, që nga pranimi deri në diplomim, ata që janë larguar apo që përsërisin vitin. Konstatuam që rregjistrat ishin të plotësuar në vazhdimësi.

[Ref 030 Modeli rregjistrave ne SM, Ref 071 Shembull ProcesVerbali mbrojtje diplomash FGJM]

Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të

Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sekretarisë mësimore dhe janë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. Këto statistika përfshihen në Raportin e Analizës Mësimore.

Ky sistem mund të aksesohet nga studentët përmes Portalit të Sekretarisë Mësimore (<https://www.bit-albania.com/upt6.php>). Ruajtja dhe përpunimi i të dhënave kryhet duke ruajtur konfidencialitetin dhe integritetin e tyre.

verifikueshme nga personat e autorizuar.	[Ref 030 Modeli rregjistrave ne SM, Ref 044 Raporti Analizes Mesimore Staf Departament]			
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Institucioni ka implementuar një sistem të qëndrueshëm dhe të sigurt për menaxhimin e të dhënave të studentëve. Monitorimi i vazhdueshëm nga specialistët e IT-së garanton ruajtjen dhe integritetin e informacionit, ndërsa kontrollet periodike sigurojnë saktësinë dhe përputhjen e të dhënave me standardet ligjore dhe institucionale. Ky proces është mbështetur nga një sistem i integruar kompjuterik, duke e bërë informacionin lehtësisht të aksesueshëm dhe të mbrojtur. Këto të dhëna i përcillen ministrisë përgjegjëse për arsim më kërkesë të saj. [Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB)]			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Departamenti në mënyrë periodike harton raporte mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. Theksojmë se shumica e studentëve të këtij PS vazhdojnë programet e ciklit të dytë. Gjurimi i punësimit të studentëve evidentohet përmes një rregjistri përkatës që mbahet dhe përditësohet nga specialist i Karrierës dhe Alumnit. [Ref 044 Raporti Analizes Mesimore Staf Departament, Ref 073 Raport i aktivitetit mësimor në nivel njësish dhe universiteti, Ref 097 Rregjistri Alumnas FGJM]			
Konkluzione	<i>UPT mbledh, administron dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me studentët dhe ecurinë e tyre akademike, duke siguruar që çdo informacion të jetë i saktë, i përditësuar dhe i aksesueshëm vetëm nga personat e autorizuar. Kjo ndihmon në monitorimin efektiv të cilësisë së arsimit dhe suksesit të studentëve, duke siguruar që institucionet të marrin masa të duhura për përmirësimin e vazhdueshëm të këtyre treguesve.</i>			
	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardit				X
-------------------------------------	--	--	--	---

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	UPT ka përfshirë studentët në jetën institucionale përmes përfaqësimit në organet si Senati Akademik, Këshilli i Fakultetit dhe Këshilli i Departamentit. Kjo sigurohet në Statutin e UPT-së (Ref 001) dhe rregulloret për organizimin e strukturave të brendshme. <i>[Ref 001 Statuti i UPT, Ref 074 Rezultatet e zgjedhjeve për Senatin Akademik, Ref 020 Vendimi i DGJZGJ për ngritjen e KPS, Ref 003 Kodi i Etikës i UPT, Ref 075 Komisionet e Senatit Akademik të UPT, Ref 019 Urdheri i Dekanit të FGJM për ngritjen e GVB]</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Nga takimi me studentët, GVJ konstatoi që organizatat studentore funksiononin dhe nëpërmjet tyre studentët përcillnin zërin dhe shqetësimet e tyre në organet drejtuese në universitet, senatin akademik, fakultet, departament. Aktualisht studentët kanë përfaqësues të tyre në organe të ndryshme të universitetit, përfshirë Senatin Akademik (4 studentë), NJQSC (1 student), NJBSC (1 student), Këshilli i Etikës (1 student), Komisioni Institucional Zgjedhor (1 student), Komisioni i Zgjedhjeve në Fakultet (1 student), KPS (1 student), GVB (1 student). Ky proces u jep studentëve një zë të rëndësishëm në drejtimin e universitetit dhe në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. <i>[Ref 001 Statuti i UPT, Ref 074 Rezultatet e zgjedhjeve për Senatin Akademik, Ref 020 Vendimi i DGJZGJ për ngritjen e KPS, Ref 003 Kodi i Etikës i UPT, Ref 073 Raport i aktivitetit mësimor në nivel njësisht dhe universiteti, Ref 019 Urdheri i Dekanit të FGJM për ngritjen e GVB]</i> <i>Ref 075 Komisionet e Senatit Akademik të UPT, Ref 070 Përfshirja e studentëve në veprimtari kërkimi FGJM, Vizita në Institucion]</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit,	Nga shqyrtimi i DVV si dhe vizita në institucion, u konstatua se njësia përgjegjëse për programin e studimit, DGJZGJ, mbledh sugjerimet e studentëve përmes mbledhjeve të përbashkëta në departamente, pyetësorëve dhe grupeve të fokusit.

rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Raporti i Anketimit Studentor, i cili hartohet në fund të çdo semestri, ofron një pasqyrë të plotë mbi përvojën dhe kënaqësinë e studentëve me programet akademike të UPT-së. Ky raport është objekt diskutimi dhe reflektimi mbi përfundimet dhe sugjerimet e studentëve gjatë procesit të rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit, duke ndihmuar kështu në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. Gjatë takimit me studentët e PS, u konstatua se shumica e studentëve të pranishëm në takim e kanë plotësuar anketimin studentor të paktën një herë. Rekomandohet që institucioni të ndërmarrë masa për të rritur pjesëmarrjen e studentëve në procesin e anketimit studentor, duke synuar që të përfshihet një përqindje më e madhe e studentëve. Një mundësi për të arritur këtë qëllim mund të jetë përmirësimi i ndërgjegjësimit të studentëve mbi rëndësinë e anketimit ose ndërlidhja e plotësimit të anketës me procedura administrative që kërkojnë pjesëmarrje të detyrueshme. <i>[Ref 060 Anketimi Studentor - Pyetësi dhe Raporti, Ref 073 Raport i aktivitetit mësimor në nivel njësish dhe universiteti, Ref 095 Informacion per studente per plotesimin e pyetesorit te lendeve, Ref 079 Raport mbi anketimin studentor cilesia e mesimdhënies]</i>
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Studenti ka të drejtë të njihet me tezën e provimit pas korrigjimit. Ai ka të drejtë të njihet me pikët totale të vlerësimit në tezë, si dhe me pikët në çdo rubrikë. Nëse studenti konstaton se ka rubrika të pakorrigjuara apo pikë të pallogaritura në vlerësimin total, ai ka të drejtë të reklamojë provimin në një kërkesë me shkrim, e cila depozitohet pranë sekretarisë mësimore të programit të studimit përkatës brenda një afati prej 3 ditë pune nga shpallja e rezultatit. Kur ankesa është e drejtë, dekani e shpall të pavlefshëm rezultatin e vlerësimit për të cilin studenti është ankuar dhe vendos që studenti të rivlerësohet ose të rijapë provimin, me të njëjtin komision, të plotësuar edhe me anëtarë të tjerë. Procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës, si dhe vendimi i marrë, dokumentohet Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. Kjo sigurohet përmes procedurave të veçanta të ankimimit dhe rishikimit të notave, të cilat janë të dokumentuara dhe të aksesueshme për të gjithë studentët.

	[Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies në UPT (Neni 35, 41), Ref 099 Model Testimi Online dhe Celësi i Përgjigjeve, Ref 100 Model testimi fizik]			
Konkluzione	Bazuar në analizën e dokumenteve dhe procedurave të UPT-së, institucioni ka përmbushur në mënyrë të plotë standardin për kriteret e përmendura më lart. UPT siguron përfshirjen aktive të studentëve në proceset vendimmarrëse dhe këshilluese, duke iu dhënë mundësi të japin kontributin e tyre në përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit dhe metodave të mësimdhënies. Kjo përfshirje jo vetëm që ndihmon në rritjen e cilësisë së arsimit, por gjithashtu fuqizon studentët dhe i përgatit ata për rolet e tyre të ardhshme profesionale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Nga Organigrama e UPT dhe FGJM, si dhe takimi me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore mësojmë se në UPT ka procedura dhe njësi të posaçme në shërbimit të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet e tij rregullatore si: • Drejtoria e Kurrikulave në përbërje të së cilës janë dy sektorë në shërbim të studentëve: - Sektori i Kurrikulave - Sektori i Procesit Mësimor • Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit që ofron shërbimin e karrierës dhe ALUMNIT Procedurat e ndjekura prej këtyre njësive në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve janë në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të vetë universitetit. [Ref 005 Organigrama e UPT, Ref 015 Organigrama FGJM]
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe	Orientimi dhe këshillimi i studentëve nis me informimin e maturantëve mbi programet e studimit të ofruara dhe vazhdon deri pas përfundimit të studimeve, nëpërmjet Zyrës së Karrierës dhe Alumnit. Institucioni, përmes departamentit, ofron udhëheqje dhe kujdestari (tutoria) për studentët, gjatë gjithë periudhës së studimeve. Departamenti ndihmon studentët që hasin vështirësi për përvetësimin e lëndëve, apo plotësimin e detyrimeve të ndryshme të

asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	programit të studimit, nëpërmjet orëve të konsultimit të zhvilluara me pedagogët, praktikë e cila vlerësohet nga studentët. <i>[Ref 020 Vendimi i DGJZGJ për ngritjen e KPS, Ref 033 Lista e pedagogëve kujdestarë, Ref 078 Rregullore Sekretarise Mesimore FGJM]</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Në UPT funksionon Zyra e Karrierës, në shërbim të këshillimit akademik të studentit, në kuadër të politikave për zgjerimin e hapësirave dhe mundësive ndërvepruese të studentëve. UPT ofron këshillim dhe monitoron zhvillimin e karrierës akademike të studentëve nëpërmjet Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe ALUMN-it, e cila shërben si urë lidhëse midis studentëve dhe tregut të punës. UPT është gjithmonë i hapur për aktivitetet e përbashkëta me industrinë. Praktikë mësimore zhvillohen në institucionet me të cilat UPT ka marrëveshje bashkëpunimi. <i>[Ref 032 Aktivitete të organizuara nga Zyra e Karrierës, Ref 096 Informacion nga specialisti i karrierës, Ref 053 Model marrëveshje për praktike mësimore]</i>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Nga studimi i DVV, takimi me stafin akademik, administrativ dhe studentët evidentuam se: Zyra e Karrierës, përmes njoftimeve në internet dhe përmes materialeve informuese të afishuara në mjediset e universitetit, njofton vazhdimisht studentët për mundësi për aplikime në lidhje me punësimin e tyre (http://upt.al/bashkepunime/veprimtari). Të gjitha strukturat e UPT, personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe personeli administrativ angazhohen për zbatimin e politikës për integrimin në punësim të studentëve. UPT disponon të dhëna, për punësimin e studentëve të vet, me të cilët mban kontakte të vazhdueshme. Për ngritjen e rrjetit Alumni ka filluar puna përmes një pyetësori për të identifikuar studentët e diplomuar në UPT dhe për të ndjekur zhvillimin e karrierës së tyre. Deri më sot është krijuar një databazë me mbi 200 të diplomuar që kanë shprehur interes për të qenë pjesë e rrjetit Alumni UPT. Në këtë kuadër edhe në FGJM është ngritur shoqata Alumna e FGJM-së. <i>[Ref 097 Regjistri i Alumnas FGJM]</i>
Konkluzione	<i>Bazuar në analizën e dokumenteve dhe procedurave të UPT-së, institucioni ka përmbushur në mënyrë të plotë standardin për</i>

	<i>kriteret e përmendura më lart. UPT siguron mbështetje për studentët përmes strukturave dhe procedurave të përcaktuara për informimin, këshillimin dhe orientimin e tyre gjatë gjithë ciklit të studimeve dhe pas diplomimit. Këto procedura dhe shërbime janë lehtësisht të arritshme dhe përdorin mjete të ndryshme për të siguruar një përvojë të mirë akademike dhe profesionale për studentët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Bazuar në DVV, UPT ka hartuar politika (Ref_002) dhe ka ngritur struktura (Ref_001- Kreu IX, neni 78) në funksion të sigurimit të brendshëm të cilësisë, duke ofruar shërbime sipas standardeve evropiane, mbështetur në Ligjin nr. 80/2015. Rrjeti i cilësisë përbëhet nga: - Njësia Qendrore e Sigurimit të Cilësisë (NJSQC), në Rektoratin e UPT dhe Njësitë e Sigurimit të Cilësisë (NJSBC) në çdo njësi kryesore të UPT. - Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë DSBC dhe Drejtoria e Kurrikulave DK, nëpërmjet FGJM, koordinojnë punën me departamentet për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Pranë FGJM është ngritur NJSBC (Ref_006). Konstatohet se, DSBC ka miratuar pyetësorët për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi në UPT (Ref_060) në të cilën përshkruhet procedura e përmirësimit të programeve të studimit, duke filluar prej analizimit të rezultateve të pyetësorëve deri në planin e masave që propozohet për përmirësim. UPT për sigurimin e cilësisë dhe përputhshmërinë e programeve të studimit të ofruara ka në strukturë edhe Drejtorinë e Kurrikulave, që merret me përputhshmërinë e planeve mësimore dhe sugjerimin

	e nevojshëm për përmirësimin e vazhdueshëm duke ndjekur aktet ligjore dhe nenet ligjore. <i>[Ref 002 Plani Strategjik 2019-2024 i UPT, Ref 001 Statuti i UPT, Ref 006 Rregullore e brendshme FGJM, Ref 060 Anketimi Studentor - Pyetësi dhe Raporti]</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	Bazuar në DVV , GVJ konstaton se UPT dhe njësitë kryesore kryejnë vlerësime të rregullta të performancës së personelit akademik, duke përfshirë mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe kontributin institucional, të gjitha këto të dokumentuara. Në fund të çdo viti akademik, personeli akademik dorëzon raportin e ngarkesës vjetore, i cili vlerësohet dhe miratohet fillimisht nga departamenti dhe më pas nga dekanati. Dekanati i FGJM ka miratuar procedura transparente për deklarimin e ngarkesës së realizuar nga personeli, duke përmbyllur plotësisht kërkesat ligjore dhe rregullative (Ref 058, Ref 059). Gjithashtu, në përfundim të çdo viti akademik, stafi akademik dhe departamentet realizojnë analiza të punës së tyre mësimore për të identifikuar objektivat e përmirësimit dhe rritjen e efektivitetit të mësimdhënies. Këto analiza përfshijnë vlerësimin e performancës së personelit dhe përcaktimin e masave për përmirësim, të cilat dokumentohen në Raportin e Analizës Mësimore të Stafit të Departamentit, duke siguruar një qasje të qëndrueshme për përmirësimin e cilësisë (Ref 044). Për më tepër, që nga viti 2018, Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ka kryer rregullisht sondazhe për të mbledhur mendimet e studentëve mbi cilësinë e mësimdhënies. Rezultatet e këtyre sondazheve analizohen me kujdes dhe përdoren për të përmirësuar procesin e mësimdhënies dhe për të adresuar në kohë reale çdo problem të mundshëm. <i>[Ref 043 Praktika e parashikimit të ngarkesës mësimore DGJZGJ/FGJM, Ref 058 Raportimi i realizimit të ngarkesës vjetore Pedagog Departament FGJM, Ref 059 Procedura e deklarimit të ngarkesës vjetore të realizuar nga PAE në FGJM, Ref 044 Raporti i Analizës Mësimore Staf Departamenti]</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve,	Universiteti garanton pjesëmarrjen aktive të studentëve në procesin e vlerësimit për çdo lëndë dhe u ofron atyre mundësinë për të shprehur mendimet e tyre përmes anketave të rregullta në bazë semestrale. Për më tepër, studentët kanë të drejtën e ankimit të rezultateve të vlerësimit në përputhje me rregulloret institucionale.

përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	[Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, Ref 060 Anketimi Studentor - Pyetësi dhe Raporti, Ref 095 Informacion për studentët për plotësimin e pyetësorit të lëndëve, Ref 079 Raport mbi anketimin studentor, cilësia e mësimdhënies, sem. I, 2021-2022]			
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (DSBC) kryen anketime semestrale që u ofrojnë studentëve mundësinë për të dhënë feedback mbi cilësinë e mësimdhënies dhe performancën e pedagogëve. Rezultatet e këtyre anketave publikohen në mënyrë transparente, duke ndihmuar në përmirësimin e vazhdueshëm të procesit mësimor. [Ref 060 Anketimi Studentor - Pyetësi dhe Raporti]			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtijshëm të mësimdhënies.	Në UPT, shembujt e praktikave të mira janë të evidentuara dhe promovohen përmes publikimeve të brendshme dhe publike, duke synuar përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies (Ref 070, Ref 073). Kështu, përmes mobiliteteve dhe aktiviteteve të tjera, UPT ka synuar përmirësimin e kapaciteteve të personelit akademik dhe cilësinë e përgjithshme të mësimdhënies. Ky angazhim ka rezultuar në një rritje të cilësisë së mësimdhënies dhe në përmirësimin e performancës akademike të institucionit. [Ref 061 Mobilitetet e realizuara 2021-2024, Ref 070 Raporti i aktivitetit të Kerkimit Shkencor pedagog departament, Ref 073 Raport i aktivitetit mësimor në nivel njësisht dhe universiteti]			
Konkluzione	UPT siguron një kornizë të strukturuar për zhvillimin, monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, duke përfshirë përdorimin e metodave inovative dhe vlerësimin e rregullt të performancës së stafit akademik dhe ndihmës akademik. Përfshirja e studentëve në këtë proces përmes anketimit dhe transparencës në publikimin e rezultateve janë elemente kyçe që kontribuojnë në garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe	UPT ka procedura dhe njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet e tij rregullatore.

procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Nga DVV dhe takimi me Institucionin mësuam se në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies ishin ngritur: - Njësia Qëndrore e Sigurimit të Cilësisë (NJSQC), në Rektoratin e UPT dhe Njësitë e Sigurimit të Cilësisë (NJSBC) në çdo njësi kryesore të UPT. - Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë DSBC dhe Drejtoria e Kurrikulave DK, nëpërmjet FGJM, koordinojnë punën me departamentet për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. DSBC dhe DK, nëpërmjet fakulteteve, koordinojnë punën me departamentet për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Pranë çdo njësie kryesore, ishte ngritur dhe funksiononte një njësi NJSBC (Ref 006). Studentët e këtij programi studimi, dhe në përgjithësi të gjithë studentët e regjistruar në programet e studimit të ofruara nga FGJM, informohen vazhdimisht më anë të postës elektronike, nga përgjegjësi i zyrës së Sigurimit të Cilësisë, Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI-t. <i>[Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies në UPT, Ref 005 Organigrama e UPT, Ref 006 Rregullore e brëndshme FGJM]</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	UPT është përgjegjës për sigurimin e brendshëm të cilësisë në të gjitha njësitë përbërëse organizative (Ref_001. Neni 78). Për këtë, funksionon Rrjeti i Cilësisë me përgjegjësinë e ngritjes, zbatimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të sistemit të cilësisë në UPT. Rrjeti i Cilësisë përbëhet nga Njësia Qendrore e Sigurimit të Cilësisë (NJSQC), e ngritur në rektoratin e UPT dhe Njësitë e Sigurimit të Cilësisë (NJSBC) në çdo njësi kryesore të UPT (Ref_005). NJSQC harton standardet institucionale të cilësisë bazuar në Kodin e proceseve vlerësuese (Ref_001). Këto standarde miratohen nga SAUPT. Një instrument shumë i rëndësishëm në procesin e sigurimit të cilësisë është dhe akreditimi institucional dhe akreditimi i programeve të studimit. Në këto procese janë dy etapa të rëndësishme: vetëvlerësimi (ose vlerësimi i brendshëm) dhe vlerësimi i jashtëm. Në vlerësimin e brendshëm krahas stafit akademik përfshihen dhe studentët si pjesë e rëndësishme e këtyre proceseve (Ref_019). Gjithashtu në vlerësimin e jashtëm një rol të rëndësishëm ka bashkëpunimi me ASCAL dhe specialistët e tij për kryerjen me sukses të akreditimit të PS (Ref_080). <i>[Ref 001 Statuti i UPT, Ref 005 Organigrama e UPT, Ref 019 Urdheri i Dekanit të FGJM për ngritjen e GVB, Ref 080 Trajnimi ASCAL mbi procesin e akreditimit të PS]</i>

Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	UPT-ja ka kaluar akreditimin e dytë institucional duke përmbushur plotësisht Standardet Shtetërore të Cilësisë dhe për rrjedhojë ka fituar akreditim gjashtëvjeçar. Gjithashtu, UPT përveç akreditimit institucional në muajt Prill-Maj 2022 i është nënshtruar dhe vlerësimit nëpërmjet sondazhit kombëtar të studentëve, rezultatet e të cilit priten të dalin së shpejti dhe të bëhen publike prej ASCAL. (https://www.ascal.al/sq/sondazhi-kombetar-i-studenteve/metodologjia-dhe-instrumentat/sks-2022) <i>[Ref 018 Vendimi Bordit ASCAL per akreditimin e UPT]</i>
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Universiteti Politeknik i Tiranës, duke pasur qëllim sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike. Në Kreun IX të Statutit të UPT-së (Ref 001) përshkruhen qartë procedurat e posaçme për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve që ofrohen. Në mënyrë periodike nëpërmjet NJSBC-së, në fund të çdo semestri përpara sezonit të provimeve, organizohet pyetësori studentor (Ref 060, 079, 095) për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e programeve të studimit. Në mënyrë periodike NJSBC-ja raporton dhe informon drejtuesit e njësive bazë dhe kryesore dhe përmes tyre të gjithë stafin e UPT-së mbi rezultatet e monitorimeve dhe vlerësimeve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njësive të tij bazë dhe individëve në të ardhmen. Gjithashtu, në përfundim të vitit akademik njësia bazë harton një raport vjetor, në të cilin përfshihen të dhëna përshkruese dhe sasiore mbi çështje që lidhen me gjendjen e programeve të studimit, stafin akademik, etj. <i>[Ref 001 Statuti i UPT, Ref 060 Anketimi Studentor - Pyetësori dhe Raporti, Ref 095 Informacion për studentët për plotësimin e pyetësorit të lëndëve, Ref 079 Raport mbi anketimin studentor, cilësia e mësimdhënies, sem. I, 2021-2022, Ref 044 Raporti Analizes Mesimore Staf Departament, Ref 058 Raportimi i realizimit të ngarkesës vjetore Pedagog Departament]</i>
Konkluzione	<i>Institucioni ka ngritur politika dhe struktura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, duke përfshirë edhe mekanizmat për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit.</i>

	<i>Institucioni ka zbatuar strategji të qarta për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë përmes angazhimit të studentëve dhe ekspertëve të jashtëm, duke treguar angazhim të institucionit për të përfshirë të gjitha palët e interesuara në procesin e përmirësimit të cilësisë.</i> <i>Përdorimi i instrumenteve dhe treguesve për sigurimin e cilësisë është i dokumentuar. Institucioni gjithashtu përdor tregues të qartë dhe të matshëm për mësimdhënie dhe kërkim, duke promovuar arritjet më të mira. Ky angazhim për matjen dhe promovimin e cilësisë është një praktikë e mirë që nxit përmirësimin e vazhdueshëm.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Procesi i riorganizimit të programeve dhe përmirësimi i tyre është i strukturuar dhe i dokumentuar në mënyrë të qartë, duke ndjekur procedurat e parashikuara në rregullore (Ref 004). Kjo përfshin hartimin dhe diskutimin e drafteve të ndryshme për të reflektuar nevojat dhe sugjerimet e departamenteve, duke i paraqitur ato për miratim në Senatin Akademik. Hartimi i drafteve të rishikimit bëhet në bashkëpunim të ngushtë midis grupeve të punës dhe drejtimit të KPS. Diskutimi i drafteve zhvillohet në nivel departamenti, me reflektimin e vendimmarrjeve dhe propozimeve përfundimtare në nivel dekanati, për të siguruar që ndryshimet të përputhen me standardet shtetërore të cilësisë dhe objektivat strategjike të institucionit. Procesi i miratimit përfshin një qasje të bazuar në analizë dhe reflektim, duke siguruar që çdo vendim për riorganizim të mbështetet nga një analizë e detajuar dhe argumentim i saktë, në përputhje me procedurat administrative të UPT (Ref 040). GVJ konstaton që, brenda periudhës në studim nga ky raport, nuk ka pasur tetativa për riorganizim të PS. Gjithashtu, nëse praktikrat e miratimit janë të qarta dhe të mirëdokumentuara, vihen re dobësi në evidentimin e arritjeve dhe dobësive, si dhe planin e masave për përmirësim.

	<i>[Ref 004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, Ref 040 Praktika e Miratimit të Planeve Mësimore]</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Procesi i mësimdhënies në UPT është objekt i analizës dhe monitorimit nga Departamentet/KPS, Fakultetet dhe Senati Akademik. Kjo analizë realizohet në fund të çdo viti akademik dhe fokusohet kryesisht në analizën e ngarkesës mësimore, si dhe aktivitetit kërkimor shkencor të realizuar nga stafi. Kjo analizë përfshin gjithashtu shqyrtimin e komenteve dhe sugjerimeve të studentëve, të cilat mbledhen përmes anketave studentore. (Ref 044, 073, 079). Vërehet mungesa e një raporti vlerësimi, ku të përfshihen të dhëna përshkruese dhe sasiore mbi çështje të tjera që lidhen më gjendjen e PS, si: stafin akademik të rekrutuar, literaturën e re të hyrë në bibliotekë, rezultatet e arritura të studentëve, kalueshmëria dhe nota mesatare, marrëveshjet e bashkëpunimit, si dhe në fund analiza SWOT, si dhe rekomandimet për të ardhmen. <i>[Ref 044 Raporti i Analizës Mësimore Staf Departamenti, Ref 073 Raporti i aktivitetit të kërkimit shkencor pedagogë departamenti, Ref 079 Raport mbi anketimin studentor cilësia e mësimdhënies, sem I 2021-2022]</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndër-institucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Në funksion të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Gjeoinformatikë”, përdoren disa metoda të drejtpërdrejta vlerësimi: - Në nivel njësie bazë: Drejtuesi i njësisë bazë informohet në mënyrë të vazhduar nga akademik i përfshirë në këtë program studimi rreth procesit të mësimdhënies, dhe ushtron kontroll rreth zbatimit të tij. Rezultatet pasqyrohen në analizat periodike të njësisë bazë (Ref 044, 070). Drejtuesi i njësisë bazë përgjigjet në Dekanatin e FGJM-së për mbarëvajtjen e procesit mësimor për programet e studimit që mbulon si njësi bazë por edhe për lëndë të veçanta që mbulohen nga njësi të tjera bazë në UPT. - Në nivel njësie kryesore: Dekani mbikëqyr zhvillimin e aktiviteteve didaktike konform strukturës mësimore dhe orarit mësimor të miratuar. Ndjek dhe monitoron cilësinë e zbatimit të kurrikulës së programit të studimit në përputhje me planin mësimor. Përpunon të dhënat e nxjerra nga analizat ngarkesës mësimore të njësive bazë përgjegjëse dhe i raporton ato në Rektorat.

	[Ref 044 Raporti i Analizës Mësimore Staf Departamenti FGJM, Ref 006 Rregullore e Brendshme e FGJM (Neni 34, pika 1), Ref 070 Raporti i aktivitetit të kërkimit shkencor pedagog departamenti]			
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	Si njësia bazë, ashtu edhe ajo kryesore, përveçse bazohej në raportet e hartuara nga stafi akademik përsa i përket mësimdhënies, ndjek edhe metodika alternative dhe plotësuese, si pyetësorët e studentëve dhe mbikqyrjen e zhvillimit të aktivitetit didaktik me kontrole rastësore në auditor. Nga takimi me studentët mësuam se në pyetësorët ruhej anonimiteti. Pyetësorët e realizuara me studentët aktualë janë periodike, dy herë në vit. Pjesë e metodikës është edhe gjurimi i Alumni, i realizuar nëpërmjet projektit GRADUA ku UPT është anëtar. [Ref 070 Raporti i aktivitetit të Kërkimit Shkencor pedagog departament, Ref 097 Regjistri i Alumnas FGJM]			
Konkluzione	Bazuar në vlerësimin e kryer, UPT ka zbatuar një pjesë të konsiderueshme të mekanizmave dhe proceseve të nevojshme për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit, duke përdorur metoda të drejtpërdrejta dhe të tërthorta vlerësimi. Procesi i riorganizimit dhe përmirësimit të programeve të studimit është i strukturuar dhe i dokumentuar mirë, me përfshirjen e aktorëve të ndryshëm institucionalë dhe me shqyrtimin e rregullt të analizave dhe rezultateve nga Departamentet, Fakultetet dhe Senati Akademik. Megjithatë, ka disa dobësi të identifikuar në lidhje me dokumentimin e arritjeve dhe dobësive të programeve, planifikimin e masave për përmirësim, dhe mungesën e raportimit të plotë për statistikën e nevojshme që lidhen me cilësinë e programeve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Në kuadër të programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Gjeoinformatikë”, institucioni nxit dhe garanton plotësimin e standardeve të cilësisë dhe përfshirjen e gjithë aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të tij në politikat dhe procedurat që lidhen me to. Në grupin e hartimit të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm të programit të këtij programi studimi, është angazhuar aktivisht edhe një përfaqësuese e studentëve. <i>[Ref 019 Urdheri i Dekanit të FGJM për ngritjen e GVB]</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	GVJ, nisur nga DVV, vëren se vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm i cilësisë në nivel institucional por edhe njësie bazë dhe kryesore, ka shërbyer për të përcaktuar objektivat të qarta për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve të ofruara në tërësi e pasqyruar kjo edhe në hartimin e objektivave të zhvillimit strategjik institucional dhe të njësisë kryesore. Në rritjen e përfshirjes së studentëve në organet kolegjiale vendimmarrëse, edhe organet rregullatore, në UPT është e miratuar një rregullore specifike për përzgjedhjen dhe organizimin në sigurimin e brendshëm të cilësisë nga radhët e stafit akademik e studentëve. <i>[Ref 008 Rregullore e brendshme e Departamenteve në FGJM, Ref 009 Plani strategjik i DGJZGJ, Ref 001 Statuti i UPT, Ref 002 Plani Strategjik 2019-2024 i UPT]</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohej përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	Në procedurat e vlerësimit të cilësisë marrin pjesë të gjithë aktorët, të cilët kanë një ndikim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në realizimin e programeve të studimit. Njësia bazë, personeli akademik dhe administrativ, si dhe studentët, luajnë një rol të rëndësishëm bashkëpunues me strukturat e sigurimit të cilësisë në nivel institucional. Janë ngritur komisione për monitorimin e vazhdueshëm të cilësisë në programet e studimit, të cilat përfshijnë stafin akademik dhe administrativ, si dhe studentët. Dekanati ka një rol të rëndësishëm në mbështetjen e politikave për sigurimin e cilësisë në fakultet (Ref 020). Grupi i Vlerësimit të Brendshëm mbështet këtë proces (Ref 019). Studentët marrin pjesë aktive në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies për çdo lëndë përmes pyetësorëve që plotësojnë në

	fund të çdo semestri (Ref 060), duke kontribuar në përmirësimin e procesit mësimor (Ref 101). <i>[Ref 075 Komisionet e Senatit Akademik, Ref 020 Vendimi DFGJM për ngritjen KPS, Ref 019 Urdhri i Dekanit të FGJM për ngritjen GVB, Ref 060 Anketimi Studentor Pyetësori dhe Raporti, Ref 101 Pyetësori i zhvilluar nga pedagogë i lëndës drejtuar studentëve]</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Institucioni respekton të drejtat themelore të çdo pale të përfshirë në jetën universitare, si dhe respekton Kodin e Etikës të UPT (Ref 003). Ngritja e grupit të vlerësimit të brendshëm bëhet mbi bazën e shmangies së konfliktit të interesit me postin që ata mbajnë. Nga takimet në institucion vërejtëm që në DGJZGJ, FGJM nuk ka asnjë praktikë ankimimi nga ana e studentëve apo stafit akademik dhe administrativ për diskriminim dhe pabarazi. Kontrolli i procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies ka garantuar barazinë e plotë midis anëtarëve të stafit akademik si dhe midis studentëve. <i>[Ref 003 Kodi i Etikës i UPT, Vizita në Institucion]</i>
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Në kuadër të vlerësimeve periodike të programeve të studimit, një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet sugjerimeve dhe rekomandimeve të dhëna nga ekspertët dhe bashkëpunëtorët e jashtëm, në fazën e riskimit të programeve të studimit, brenda masës së lejuar deri në 20%. GVJ ka evidentuar se njësitë bazë dhe departamentet e FGJM kanë mungesë të një strukture të konsoliduar për vlerësimin e cilësisë. Kjo ndikon në aftësinë e institucionit për të operuar me të njëjtat metodologji dhe instrumente si NJSBC/NJQSC-së. Nuk ekziston një praktikë periodike vjetore e marrjes së feedback-ut nga ekspertët e jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit, duke përfshirë biznesmenë, institucione publike dhe private ku të diplomuarit e një programi studimi janë punësuar.
Konkluzione	<i>Bazuar në analizën e kryer, është e qartë se UPT ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të përfshirë aktorët e brendshëm dhe të jashtëm në proceset e sigurimit të cilësisë së programeve të studimit. Institucioni ka struktura të qarta dhe politika të miratuara për përfshirjen e studentëve, stafit akademik dhe administrativ në këto procese, duke garantuar gjithashtu shmangien e konfliktit të interesit dhe respektimin e barazisë dhe të drejtave themelore të secilit individ.</i> <i>Megjithatë, vërehet se ka nevojë për përmirësim në lidhje me krijimin e një strukture të konsoliduar për vlerësimin e cilësisë në nivel njësie bazë dhe departamenti, si dhe për përfshirjen e</i>

	<i>rregullt të ekspertëve të jashtëm dhe bashkëpunëtorëve në këto procese.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Universiteti Politeknik i Tiranës ka bërë publike politikat, strategjitë dhe veprimtaritë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për të gjitha programet e studimit, përmes faqes zyrtare (http://upt.edu.al/). Publikimi i Statutit, Vendimeve të Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit, si dhe raportet e anketimit të studentëve, kanë krijuar një mjedis transparent për aktorët e brendshëm dhe të jashtëm. [http://upt.edu.al/]
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Raporti vjetor i veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore të Institucionit përfshin të dhëna të përmbledhura statistikore për secilin program studimi, duke ruajtur dhe respektuar lirinë akademike, kodin e etikës dhe sigurinë e të dhënave personale. Raporte të cilat ruhen në arkivin institucional konform akteve rregullatore në fuqi. [Ref 044 Raporti i Analizës Mësimore Staf Departamenti FGJM, Ref 073 Raporti i aktivitetit të kërkimit shkencor pedagog departamenti]
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë kryen rregullisht anketimet semestrale mbi cilësinë e mësimdhënies, që nga viti 2018. Studentët plotësojnë pyetësorët për çdo pedagog, dhe rezultatet analizohen nga Rektori për të identifikuar pikat e forta dhe dobësitë e secilit departament dhe pedagog. [Ref 060 Anketimi Studentor - Pyetësori dhe Raporti, Ref 095 Informacion për studentët për plotësimin e pyetësorit të lëndëve, Ref 079 Raport mbi anketimin studentor, cilësia e mësimdhënies, sem. I, 2021-2022]

Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	UPT ka bazuar përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies në ngritjen e strukturave si Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Drejtoria e Kurrikulave. Këto struktura janë përgjegjëse për respektimin e standardeve, përgatitjen e planeve mësimore, dhe analizimin e cilësisë së mësimdhënies dhe performancës së studentëve. Monitorimet dhe vlerësimet periodike janë kryer rregullisht nga njësitë bazë dhe kryesore, duke siguruar përputhje me standardet dhe nevojat e tregut të punës. UPT mbetet i angazhuar në një proces të vazhdueshëm për përmirësimin e cilësisë, duke përfshirë të gjithë aktorët kyç në këtë proces. <i>[Raporti i Vlerësimit të Brendshëm]</i>
--	---

Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Në nivel institucional, Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë organizon në mënyrë periodike seanca informuese/trajnuese me stafin akademik dhe atë administrativ për rritjen e vetëdijes institucionale rreth përmirësimit afatgjatë të cilësisë. DGJZGJ, pedagogët koordinatorë për çdo program studimi, në fillim të çdo viti akademik në javët orientuese, si dhe pas çdo procesi të vlerësimit të jashtëm, informojnë studentët dhe stafin akademik mbi rëndësinë e vlerësimit të cilësisë dhe akreditimit të programeve të studimit. <i>[Ref 017 Agjenda e akreditimit të PS në FGJM, Ref 018 Vendimi Bordit ASCAL për akreditimin e UPT, Ref 098 Takime me DSBC dhe ASCAL]</i>
--	---

Konkluzione	<i>Institucioni ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të bërë transparente dhe publike politikat, proceset dhe veprimtaritë e tij lidhur me Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programet e studimit. Publikimi i këtyre materialeve në faqen zyrtare të Universitetit, përfshirja e studentëve dhe personelit akademik në proceset e vlerësimit dhe angazhimi në aktivitete ndërgjegjëse kanë krijuar një kulturë të brendshme të cilësisë. Kjo tregon një përkushtim të vazhdueshëm për përmirësimin afatgjatë të cilësisë së arsimit dhe shërbimeve të ofruara.</i>			
--------------------	--	--	--	--

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Inxhinieri Gjeoinformatikë” të ofruar nga Universiteti Politeknik i Tiranës

Pikat e forta dhe afirmime:


1. **Unik dhe student të kualifikuar:** Fakulteti Gjeologji Miniera dhe Departamenti i Gjeologjisë së Zbatuar dhe Gjeoinformatikës ofron programin Bachelor në “Inxhinieri Gjeoinformatikë” e cila është unike në Republikën e Shqipërisë dhe kontribuon në nivel kombëtar përmes përgatitjes së studentëve të kualifikuar në fushën e sistemeve informatike dhe sistemet e gjeoinformacionit;
2. **Stafi Akademik:** Programi ka një staf akademik të kualifikuar, me përqindje të lartë të mbulimit të ngarkesës mësimore nga personeli efektiv. Aktivitetet kërkimore dhe botuese të stafit janë të lidhura ngushtë me lëndët e programit
3. **Infrastruktura mbështetëse për mësimdhënie dhe formim praktik:** Fakulteti disponon mjedise mësimore dhe laboratorë të përshtatshëm për nevojat e programit, megjithëse infrastruktura është aktualisht në rikonstruksion, çka tregon perspektive për përmirësime të mëtejshme.
4. **Sistemi i Menaxhimit Institucional:** UPT ka një sistem dixhital për menaxhimin akademik dhe administrativ, duke përdorur platformën BIT-ALBANIA për administrimin e të dhënave të studentëve në programin e studimit.
5. **Marrëdhënie Bashkëpunimi:** UPT ka një numër të konsiderueshem bashkëpunimesh me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe të huaj. Nëpërmjet këtyre bashkëpunimeve realizohen objektivat e realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor, shkëmbimit të eksperiencave dhe punësimit të të diplomuarve.

Pika të dobta:

1. **Kufizimi në Qasjen e Burimeve Bibliotekare dhe Elektronike:** Biblioteka specifike e FGJM është jashtë funksionit për shkak të rikonstruksionit, dhe literatura ndihmëse është e papërditësuar. Aksesimi në burime elektronike është gjithashtu i kufizuar, çka ndikon negativisht në përgatitjen e studentëve (Standardi IV.3, Kriteri 6).
2. **Platforma BIT-ALBANIA me funksionalitete të kufizuara:** Sistemi aktual i menaxhimit nuk ofron mundësi interaktive për komunikimin dhe monitorimin në kohë reale të aktiviteteve akademike dhe administrative. Kjo vështirëson ndjekjen e progresit të studentëve dhe përditësimin në kohë reale të mungesave dhe vlerësimeve progressive të tyre. (Standardi IV.4, Kriteri 3)
3. **Literaturë e kufizuar bashkëkohore në gjuhën shqipe:** Literatura në disa raste nuk përfshin tekste të 5 viteve të fundit [Standardi II.4/Kriteri 5];

Rekomandime:

1. **Rregullore e programit të studimit:** GVJ rekomandon që të përfshihet në një dispozitë të veçantë në Rregulloren e programit të studimit për procedurën e zhvillimit



të praktikës mësimore, detyrimet e studentit në lidhje me të dhe vlerësimet përkatëse [Standardi I.1, kriteri 3];

2. **Strategjite në nivel institucional dhe nivel njësi kryesore dhe bazë:** GVJ konstaton se strategjitë tashmë janë në limite kohore të tyre dhe propozon një rishikim të tyre [Standardi I.1, kriteri 3];
3. **Kompetencat:** Propozojmë që programi duhet të forcojë kompetencat e studentit edhe në fushën e informatikës duke i siguruar një specializim më të mirë edhe në këtë fushë [Standardi II.4, kriteri 1];
4. **Elementët e vlerësimit:** Unifikim të kriterëve në lidhje me elementët e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve [Standardi III.2, kriteri 3];
5. **Mësime të hapura:** GVJ rekomandon si më sipër marrjen në konsideratë nga ana e DGJZGJI të mësimeve të hapura dhe zhvillimin e tyre gjatë vitit akademik [Standardi III.4, kriteri 5];
6. **Pasurimi i literaturës me tekste në gjuhën shqipe:** GVJ rekomandon pasurimin me tekste në gjuhën shqipe dhe përditësimin e literaturës me publikime të reja. Gjithashtu, përfundimi i rikonstruksionit të bibliotekës dhe pasurimi i saj me literaturë të përditësuar, si dhe instalimi i posteve kompjuterike për të lehtësuar përdorimin e burimeve elektronike si sistemi COBISS do të ishte një vlerë e shtuar [Standardi IV.3, Standardi II.4/Kriteri 5].
7. **Zgjerimi i funksionaliteteve të platformës BIT-ALBANIA:** Përfshirja e moduleve për regjistrimin e mungesave, vlerësimin progresiv dhe komunikimin interaktiv ndërmjet stafit dhe studentëve për të përmirësuar monitorimin dhe transparencën [Standardi IV.4/kriteri 5].

Evaluation Conclusions for the First-Cycle Bachelor Program in "Geo-Informatics Engineering" Offered by the Higher Education Institution "Polytechnic University of Tirana"

Strengths and affirmations

1. **Unique and Qualified Students:** The Faculty of Geology and Mining and the Department of Applied Geology and Geoinformatics offer a Bachelor's program in "Geoinformatics Engineering", which is unique in the Republic of Albania and contributes at a national level by preparing qualified students in the field of information systems and geoinformation systems.
2. **Academic Staff:** The program has a qualified academic staff, with a high percentage of teaching load covered by effective personnel. Research and publishing activities of the staff are closely aligned with the program's courses.
3. **Supportive Infrastructure for Teaching and Practical Training:** The Faculty provides suitable teaching environments and laboratories tailored to the program's needs. Although the infrastructure is currently under reconstruction, this indicates potential for further improvements



4. **Institutional Management System:** UPT employs a digital system for academic and administrative management, utilizing the BIT-ALBANIA platform for managing student data within the study program.
5. **Collaborative Relationships:** UPT maintains a significant number of collaborations with institutions, companies, third parties, and both local and international business stakeholders. Through these partnerships, the program achieves its objectives in professional development, scientific research, internships, and graduate employment.

Weaknesses

Limited Access to Library and Electronic Resources: The FGJM-specific library is non-operational due to reconstruction, and supplementary literature is outdated. Access to electronic resources is also restricted, limiting students' preparation. (Standard IV.3, Criterion 6).

Limited Functionality of the BIT-ALBANIA Platform: The current management system does not provide interactive features for real-time communication and monitoring of academic and administrative activities. This hinders tracking students' progress and updating attendance and progressive evaluations in real-time. (Standard IV.4, Criterion 3)

Limited Contemporary Literature in Albanian: In some cases, the literature does not include texts published within the last five years. (Standard II.4/Criteria 5).

Recommendation

1. **Study Program Regulation:** GVJ recommends including a specific provision in the study program regulation regarding the procedure for conducting practical training, the student's obligations related to it, and the corresponding evaluations [Standard I.1, Criterion 3];
2. **Strategies at the Institutional and Unit Levels:** GVJ notes that the current strategies are approaching their time limits and proposes their revision [Standard I.1, Criterion 3];
3. **Competencies:** We propose that the program should strengthen students' competencies in the field of informatics, ensuring better specialization in this area as well [Standard II.4, Criterion 1];
4. **Evaluation Elements:** Standardization of criteria related to evaluation elements and knowledge assessment [Standard III.2, Criterion 3];
5. **Open Lectures:** GVJ recommends that DGJZGJI consider implementing open lectures and organizing them throughout the academic year [Standard III.4, Criterion 5].
6. **Enrichment of Literature with Texts in Albanian Language:** GVJ recommends enriching the literature with texts in the Albanian language and updating the literature with new publications. Additionally, the completion of the library's reconstruction and its enrichment with updated literature, as well as the installation of computer stations to facilitate the use of electronic resources such as the COBISS system, would be an added value [Standard IV.3, Standard II.4/ Criterion 5].

Expansion of BIT-ALBANIA Platform Functionality: Incorporating modules for attendance tracking, progressive evaluations, and interactive communication between staff and students to improve monitoring and transparency [Standard IV.4/ Criterion 5].



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X